

# Basic Education Program



**Zhvillimi i Shkathësive të  
Shekullit 21 në klasat me  
NXËNËSIN NË QENDËR**

mendimi kritik  
mesimi përvorë  
loja  
gjithpërtshirëse  
teknologjia  
nxënësi në qendër  
TIK ndryshim  
kreativ zgjidhja e problemit  
veprim  
kompetencat kryesore  
autentik  
shkathësitë e shekullit 21



**Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.**

---

---

**Doracaku është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për arsimin themelor (Basic Education Program të USAID-it) të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).**

---



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*



# Basic Education Program

**Zhvillimi i Shkathtësive të  
Shekullit 21 në klasat me  
NXËNËSIN NË QENDËR**

## **REDAKTIMI DHE HARTIMI**

Flaurie Storie

## **REDAKTIMI**

Keith Prenton

## **PËRKTHIMI**

Jehona Xhaferi

## **DIZAJNI GRAFIK**

indesign

## **BOTIMI I PARË**

Janar, 2013

---

## **FALENDERIME:**

Ky udhëzues për mësimdhënësit është përshtatur nga një doracak i ngjashëm i përgatitur si pjesë e Projektit për Arsimin Fillor të USAID-it në Maqedoni. Programi i Arsimit Themelor (BEP) ka ripunuar këtë udhëzues, duke e përshtatur me rrethanat e arsimit në Kosovë dhe duke shtuar disa sektorë (si p.sh. barazia gjinore). BEP ka mbledhur shembuj dhe rrëfime nga mësimdhënësit e Kosovës të cilët kanë implementuar një apo më shumë kurse nga ky program. Programi falënderon Jehona Xhaferi dhe fasilituesit e shkollave të cilët ndihmuan këtë përpjekje. Programi, në radhë të parë, u shpreh mirënjohje mësimdhënësve të cilët vullnetarisht kanë bërë ndryshime në mësimdhënien dhe mësimnxënien në klasë. Shpresojmë që përpjekjet e juaja të demonstruara në këtë udhërrëfyes të shërbejnë si model për të tjerët.

---

## Mirësevini edukatorë

Ky doracak synon tu ndihmojë mësimdhënësve t'i kuptojnë ndryshimet që po ndodhin në përgjithësi në arsim e në veçanti në Kosovë. Këto ndryshime përfshijnë: reformën e kurrikulës, metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe prezantimin e teknologjisë së re në shkolla.

Ky doracak ka për qëllim t'u ndihmojë mësimdhënësve t'i përgatisin nxënësit për punë dhe jetë në shekullin 21 duke e kaluar theksin nga mësimdhënia e njohurive nxënësve pasiv në atë të zhvillimit të kompetencave, shkathhtësive dhe qëndrimeve përmes mësimnxënies aktive. Ai u ndihmon mësimdhënësve ta ri-orientojnë klasën e tyre në një klasë me nxënësin në qendër. Shumica e nxënësve (dhe të rriturve) mësojnë më lehtë kur kanë mundësi të përjetojnë ndonjë gjë në mënyrë më aktive. Një proverbë kineze e shpreh këtë në mënyrë shumë të thjeshtë:

**Unë dëgjoj ... Unë harroj**  
**Unë shoh ... Unë mbaj mend**  
**Unë bëj ... Unë kuptoj**

Ky doracak dedikohet për përdorim në kursin Klasat me Nxënësin në Qendër të organizuar nga Basic Education Program i USAID-it por mund të përdoret edhe si burim referencash për mësimdhënës individual që dëshirojnë t'i modernizojnë qasjet e tyre të mësimdhënies apo për shkolla që i organizojnë aktivitetet e tyre të zhvillimit profesional. Audiencia të cilën e synon ky doracak përfshin mësimdhënës, drejtorë shkollash, pedagogë dhe të tjerë që janë të përfshirë në zhvillimin e shkollave për t'i plotësuar nevojat e nxënësve të shekullit 21.

Ky doracak mund të përdoret edhe për vetë-reflektim dhe për monitorimin e mësimdhënies dhe të nxënies në shkolla.


Ky doracak është pjesë e një 'kutie mjeteve apo 'arke thesari' më të gjerë të burimeve për mësimdhënës, të zhvilluara nga Basic Education Program të USAID-it, i cili është në dispozicion në [bep-ks.org](http://bep-ks.org) dhe në Ueb Portalin Arsimor të MASHT-it. Këto burime përfshijnë:

- Doracakë të tjerë;
- Video burime;
- Burime të tjera digjitale;
- Ueb faqe të miratuara



**Informata të tjera mbi zbatimin e kurrikulës së re mund të gjenden në "Doracaku për Praktikën e Përmirësuar në Klasë" të botuar nga MASHT-i me përkrahje nga BE.**

## Çka ka në këtë doracak për mësimdhënësit?



*Ky synon të ofrojë përgjigje për disa nga pyetjet dhe brengat tuaja si dhe t'ju njoftojë me terminologjinë arsimore të kohës së sotme.*

*“Çka do të thotë mësimdhënia aktive?”*

*“Si mund ta organizoj më së miri klasën time?”*

*“Si mund ta menaxhoj klasën time nëse nxënësit janë duke punuar në qendra të ndryshme me aktivitete të ndryshme?”*

*“Cili është dallimi në mes të nxëniet e bazuar në probleme dhe të nxëniet e bazuar në projekte?”*

*“Si mund ta përdori TIK-un dhe teknologjitë tjera në projekte praktike?”*

*“Çka mund të bëj për tu siguruar që të gjithë nxënësit ndjehen të mirëseardhur dhe të kujdesur?”*




*Ofron ide praktike për njësitë mësimore për ta përmirësuar të nxëniet e nxënësve dhe zhvillimin e shkathtësive që u nevojiten në shoqërinë e shekullit 21.*

**Ju ofron linqe me shumë burime të tjera për mësimdhënien tuaj dhe e përkrah zhvillimin tuaj profesional.**

## PËRMBAJTJA

<b>Mirësevini edukatorë</b> .....	5
<b>Çka ka në këtë libër për mësimdhënësit?</b> .....	6
<b>Si ta përdori këtë doracak?</b> .....	8
Legjenda .....	9
'Arka e Thesarit' për klasën e Shekullit 21 .....	10
Fjalor i nocioneve .....	12
<b>1. Arsimimi i Shekullit 21 në Kosovë</b> .....	15
1.1 Pse duhet të ndryshojnë shkollat? .....	16
1.2 Kurrikula e Kosovës: Kurrikula e Shekullit 21 .....	18
1.3 Pedagogjia e Shekullit 21.....	22
1.4 Vlerësimi për Nxënie .....	24
1.5 Teknologjia në Përkrahje të të Nxënit & Zhvillimit të Shkathtësive .....	26
1.6 Klasa e Shekullit 21.....	28
<b>2. Aspekte të mësimdhënies dhe të nxënit në shekullin 21</b> .....	31
2.1 Qasja është qasja e bazuar në temë? .....	32
2.2 Të nxënit përmes lojës konstruktive .....	34
2.3 Mësimi autentik .....	36
2.4 Loja me role: përdorimi i dramës .....	38
2.5 Strategjitë për mendim Kritik .....	40
2.6 Vlerësimi për Nxënie .....	42
2.7 Vetë-vlerësimi .....	44
2.8 Vlerësimi i bashkëmoshatarëve .....	46
2.9 Vlerësimi me anë të dosjes së nxënësve .....	48
2.10 Të nxënit e bazuar në probleme .....	50
2.11 Të nxënit e bazuar në projekte .....	52
2.12 Hulumtimi i pavarur .....	54
2.13 Projektet në veprim .....	56
2.14 Projektet e sfidës së dizajnit .....	58
2.15 Të nxënit ndërmarrës .....	60
2.16 Integrimi i Barazisë Gjinore në Klasë .....	62
2.17 Klasa gjithpërfshirëse .....	65
<b>Fusnotat</b> .....	66
<b>Referencat</b> .....	67

# Si ta përdori këtë doracak?



## Për referencë të shpejtë dhe drejtim

Mësimdhënësit mund të jenë profesionistë shumë të zënë, që nuk kanë kohë gjithnjë për të bërë hulumtime të detajuara.

Si rrjedhojë, thelbi i këtij doracaku është t'ju përkrahë me njohuri teknike dhe ide praktike. Shpresojmë se kjo do të ju mundësojë t'i kuptoni më lehtë dhe më shpejtë dhe pastaj t'i zbatoni në praktikën tuaj të mësimdhënies.

Përmbajtja e doracakut përfshin:

- Njohuri të përmbledhur teorike mbi zhvillimet e fundit në mësimdhënie;
- Udhëzime dhe hapa themelor për mënyrën se si t'i zbatoni qasjet e mësimdhënies; dhe
- Shembuj praktik të aktiviteteve të zbatuara në shkollat e Kosovës, në të cilët zbatohen këto qasje.

Pjesët kryesore janë:

## “Arsimimi i Shekullit 21 në Kosovë”

Në këtë pjesë mund të gjeni disa ide shumë interesante për trendet e reja në arsim. Në secilën pjesë do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të temës, si mund ta përmirësojë të nxënit e nxënësve tuaj dhe si mund t'i plotësojë nevojat e fuqisë punëtore dhe shoqërisë së shekullit 21.

## “Mësimdhënia dhe të Nxënit në Klasat me Fëmijën në Qendër”


Kjo pjesë përmban dyfaqëshe që përfshijnë informata mbi aspektet e mësimdhënies dhe të nxënit modern, si qasje efektive që mund ta ndihmojnë mësimdhënësin tuaj në atë mënyrë që u mundëson nxënësve ta kuptojnë përmbajtjen më mirë, t'i zhvillojnë shkathtësitë që u duhen për jetë në shekullin 21 dhe të jenë më të suksesshëm në të nxënit e tyre. Më e rëndësishmja është se do t'ju ndihmojë në ndryshimin e praktikës tuaj në klasë nga ajo që përqendrohet në mësimdhënësin në atë ku nxënësit mësojnë në mënyrë të pavarur. Kështu që, theksi vëhet në të nxënit.

Secila temë ofron përgjigje në këto pyetje:

- Cila është qasja?
- Pse të përdoret kjo qasje? Cilat janë dobitë?
- Si dallon ajo nga të nxënit tradicional?
- Si duket kjo qasje? Si duket një shembull konkret?
- Si ta bëj të suksesshme?

## Doracakët tjerë

Ky doracak u dedikohet të gjithë mësimdhënësve të shkollave fillore. Ekzistojnë doracakë të tjerë të cilët janë specifik për një lëndë apo klasë dhe ndoshta të gjithë mësimdhënësit do të dëshirojnë t'i konsultojnë.







### Doracaku për 'Renovimin' e Klasës

...që përmban informata se si mësuesit mund të krijojnë mjedis të nxënies me të përshtatshme për fëmijë duke ndryshuar mjedisin fizik të klasës.

### Doracaku për Vlerësimin për Nxënie

...një udhëzues i plotë për mësuesit dhe edukatorë të tjerë në lidhje me vlerësimin e përditshëm për nxënies duke përfshirë përfshirjen e nxëniesve.



### Udhëzues për Lëndë dhe Klasë të Ndryshme






...udhëzuesit në dispozicion përfshijnë: Leximin (1-5), Matematikën (1-9), Shkencat (6-9), Teknologjinë (7-9), Të Nxënies në Lidhje me Mjedisin (6-9), Përdorimi i TIK-ut në Mësuesin e Gjuhës Angleze (6-9), Klubet e Nxëniesve për Përkrahje Teknike (7-9) – online.



### Linqet për 'Arkën e Thesarit' dhe burime të tjera

Në këtë doracak do të gjeni edhe detaje dhe referenca, ueb faqe dhe kontakte të dobishme. [\(shih faqen 67\)](#)

### Legjenda

	<b>Shembuj konkret apo tregime nga shkolla</b>
	<b>Aktivitetet në klasë</b>
	<b>Me rëndësi të madhe</b>
	<b>Vegëzat e ndryshme p.sh. shiko fq x, referim në uebfaqe, etj.</b> 

# 'Arka e Thesarit' për klasën e Shekullit 21

**Çka ka në 'Arkën e Thesarit'?**



**Basic Education Program in Kosovo**

**GJUHET**  
English | Shqip | Srpski

**BEP MENU**

- > Ballina
- > Për ne
- > Lajme
- > Kontakt
- > BEP CONNECTI
- > PROJEKTI "CLASSROOM MAKEOVER"
- > Microsoft Forumi i Edukatorëve Inovatorë

**THE SARI ARSIMOR**

**NGJARJET VJUESJE**  
Kalendari i ngjarjeve vjuesje

**PARTNERET E BEP-IT**

- > FHI 360
- > KEC
- > MASHT
- > Microsoft Partners in Learning
- > USAID-i në Kosovë

**BEP NË FACEBOOK**

**Kosovo Basic Education Program**  
1,226 people like Kosovo Basic Education Program.

## Çka ka në 'Arkën e Thesarit'?

- *Doracakët*
- *Uebfaqe interaktive*
- *Shembuj të planeve mësimore*
- *Raste studimi të projekteve*
- *Video filma*
- *Mjete vlerësimi për nxënës*
- *Mjete vetë-vlerësimi për mësimdhënës*
- *Mjete vetë-vlerësimi për shkollën*
- *Linqe për burime të tjera të jashtme*

Në Arkën e Thesarit do të gjeni edhe artikujt në vijim në pjesën e quajtur "Lexim të avansuar për Klasat me Nxënësin në Qendër". Kjo do t'ju sigurojë lexim të mëtutjeshëm në lidhje me temat që gjenden në këtë doracak.

### Lexim i avansuar për Klasën me Nxënës në Qendër

1	Mësimi i Diferencuar
2	Menaxhimi i Klasës: Një Qasje Proaktive
3	Qendrat e të Nxënit në Klasë
4	Të Pyeturit në Klasë
5	Udhëzime Shtesë për të Nxënit Autentik
6	Udhëzime Shtesë mbi Të Nxënit e Bazuar në Projekte
7	Udhëzime Shtesë mbi Të Nxënit e Bazuar në Probleme
8	Principet për Mësimin e Zgjidhjes së Problemeve
9	Taksonomia e Blumit
10	Konstruktivizmi
11	Ngritja e Angazhimit dhe Motivimit të Nxënësve
12	Detyrat e Shtëpisë
13	Udhëzime Shtesë për Përdorimin e Vetë-vlerësimit
14	Bazat e Barazisë Gjinore
15	Përfshirja e Prindërve në Shkollat me Nxënësin në Qendër
16	Udhëzime Shtesë mbi Hulumtimin në Veprim

### Ky material mund të:

- ju ofrojë bazë dhe arsyeshmëri teorike;
- ju ofrojë udhëzime shtesë përderisa e provoni një qasje të re; dhe
- ju ofrojë disa mjete të cilat mund t'i përdorni gjatë mësimdhënies tuaj.

## Fjalori i nocioneve

Nocioni	Definicioni
Të nxënit në veprim	Lloj i të nxënit konstruktiv ku nxënësit mësojnë në mënyrë që të ndërmarrin veprim i cili do të krijojë ndryshim dhe përmirësim.
Projekt në veprim	Projekt që synon ndërmarrjen e veprimit i cili do të krijojë ndryshim dhe përmirësim.
Hulumtimi në veprim	Proces i vazhdueshëm ku profesionistët reflektojnë në praktikën e tyre dhe marrin hapa për ta përmirësuar atë. Shpesh hulumtimi në veprim është bashkëpunues dhe mësimdhënësit punojnë së bashku për t'i planifikuar aktivitetet dhe për t'i krahasuar gjetjet.
Dosja e vlerësimit	Koleksion i organizuar dhe sistemuar i punës së nxënësve i cili përfaqëson përpjekjet e bëra nga secili nxënës, përparimin e tij/saj dhe të arriturat në një apo më shumë lëndë.
Vlerësimi autentik	Informata për të nxënit e nxënësit përdoret si informatë kthyesë që nxënësi dhe mësimdhënësi ta përmirësojnë mësimdhënien dhe të nxënit në të ardhmen.
Të nxënit autentik	Qasje në të cilën nxënësit hulumtojnë, punojnë në detyra dhe zgjidhin probleme nga jeta reale, duke përdorur metoda dhe mjete të ngjashme si profesionistët e vërtetë.
Detyrat autentike	Këto janë detyra ku nga nxënësit kërkohet të zgjidhin probleme të jetës reale siç bëjnë profesionistët.
Taksonomia e Blumit	Klasifikim i objektivave të ndryshme që cilat edukatorët i përcaktojnë për nxënësit (objektivat e të nxënit). Taksonomia u propozua për herë të parë në vitin 1956 nga Benjamin Bloom, por u rishikua në vitin 2001 nën emrin "Taksonomi për të nxënit, mësimdhënien dhe vlerësimin."
Mendimi kreativ	Proces mendor që përfshin gjenerim të ideve, zgjidhjeve apo koncepteve të reja apo asocime të reja të mendjes kreative në mes të ideve apo koncepteve ekzistuese.
Mendimi kritik	Mendimi kritik është modalitet i të menduarit që është i qartë, racional, i hapur dhe i informuar në bazë të dëshmive. Përfshin shkathtësi të të menduarit të nivelit të lartë si analiza, vlerësimi dhe krijimi.
Qasja ndërkurrikulare	Nxënësit punojnë në një detyrë apo projekt i cili përfshin më shumë se një lëndë kurrikulare. Qasja mund të kërkojë që mësimdhënësit të punojnë së bashku për të planifikuar dhe zbatuar.
Të nxënit përmes sfidës së dizajnit	Një lloj i të nxënit konstruktiv ku nxënësit mësojnë në mënyrë që të gjejnë zgjidhje për një sfidë dizajni që shpesh herë përfshin problem autentik.
Mësimi i diferencuar	Mësimi i diferencuar ndodh kur disa nxënës punojnë në detyra të ndryshme nga të tjerët. Kjo është shumë e dobishme kur nuk ka mangësi të hapësirës apo paisjeve në klasë apo kur mësimdhënësi dëshiron tu ofrojë më shumë ndihmë një grupi të vogël.
Edukimi në bazë të përvojës	Filozofi dhe metodologji përmes së cilës edukatorët sigurojnë përvoja të drejtpërdrejta për nxënësit dhe e ndihmojnë reflektimin në mënyrë që ta ngritin njohurinë, t'i zhvillojnë shkathtësitë dhe t'i qartësojnë vlerat. <a href="http://www.aee.org">www.aee.org</a>
Të nxënit përmes përvojës	Të nxënit përmes reflektimit mbi atë që bën, nxënësi zbulon dhe eksperimenton në radhë të parë, në vend se të dëgjojë apo lexojë për përvojat e të tjerëve.

Detyrat shtesë	Këto janë detyra të përcaktuara për individë apo grupe të nxënësve të cilat zgjasin për një periudhë kohore dhe nuk përfundojnë gjatë një periudhe.
Vlerësimi i jashtëm	Lloji i vlerësimit, që organizohet nga një organ i jashtëm, jashtë shkollës.
Motivimi i jashtëm	Ku nxënësi motivohet të mësojë nga ndonjë shpërblim i jashtëm apo kërcënim me dënim. Motivimi nuk ka ndonjë lidhje direkte me të nxënësit.
Vlerësimi formativ	Një emër tjetër për vlerësimin formativ është 'vlerësim për nxënie' e që është fokusi i këtij doracakut.
Barazia gjinore	Barazia gjinore ka të bëjë me mundësi të <b>barabarta</b> për të gjitha qeniet njerëzore për të jetuar, zhvilluar dhe për të bërë zgjedhje. Ka mundësi të barabarta për të gjitha vajzat dhe djemt në të gjitha sferat e jetës.
Integrimi gjinor	Integrimi gjinor përfshin konsideratë gjinore në të gjitha aspektet e funksionimit të një shoqërie qoftë në nivel të sistemeve, institucioneve apo nivel personal me qëllim kryesor të lëvizjes së shoqërisë përpara drejt ngritjes së barazisë gjinore.
Aktivitetet grupore	Nxënësit punojnë së bashku në një detyrë të përbashkët për të hulumtuar apo zgjidhur probleme.
Të nxënësit e pavarur	Nxënësit, individualisht apo së bashku, shfrytëzojnë burime, të pavarur nga mësimdhënësi, për të gjetur informata.
Motivimi i brendshëm	Ku nxënësi është i motivuar të mësojë në bazë të interesimit, kërkësisë apo kënaqësisë në lidhje me të nxënësit. Motivimi vjen nga brendia e nxënësit.
Klasa me nxënësin në qendër	KNQ është klasë mike për fëmijë ku nxënësit mësojnë dhe mirëqenia e tyre është fokusi kryesor i të gjitha qasjeve, etj.
Përfshirja e prindërve	Ku prindërit përfshihen në mënyrë pozitive në aktivitetet e shkollës në mënyrë që ta ngritin edukimin e fëmijëve të tyre, përmes ndihmës në klasë dhe/apo përmirësimit të etikës dhe objektivit të shkollës.
Vlerësimi i bashkëmoshatarëve	Metodë e vlerësimit të nxënësve nga nxënësit tjerë në mënyrë që të ngritet të kuptuarit e qëllimeve që duhet të arrihen, të ngritet të nxënësit dhe të nxitet mendimi kritik dhe shkathtësitë e komunikimit.
Të nxënësit në bazë të projekteve	Metodë sistematike e mësimdhënies që i angazhon nxënësit t'i mësojnë njohuritë themelore dhe shkathtësitë për jetë më të mirë përmes një procesi kërkimi të zgjeruar, të ndikuar nga nxënësit e të strukturuar rreth pyetjeve komplekse e autentike dhe produkteve e detyrave të dizajnuara me kujdes.
Të nxënësit përmes problemeve	Qasje e ngjashme pedagogjike me të nxënësit në bazë të projekteve, megjithatë qasja e bazuar në probleme i strukturon nxënësit në aktivitete më shumë duke kërkuar nga ata të zgjidhin probleme specifike (të hapura).
Loja me role	Nxënësi i merr qëndrimet, veprimet dhe rrjedhën e një situatë tjetër, sidomos në situatë imagjinare, në përpjekje për ta kuptuar këndvështrimin apo ndërveprimin shoqëror të tjetrit. Personazhi mund të jetë imagjinar, real apo historik
Vet-vlerësimi	Metodë vlerësimi në të cilën nxënësit e vlerësojnë procesin e vet të të nxënësit.
Vet-reflektimi	Kontrollim kritik i vetvetës për të përcaktuar efektshmërinë e vendimeve personale dhe ndonjë veprim tjetër përmirësues që mund të jetë i nevojshëm.
Vlerësimi sumativ	Lloji i vlerësimit i cili i përmbledh të arriturat e nxënësit në një kohë të caktuar.



# 1. Arsimi i shekullit 21 në Kosovë

## ***Të dashur mësime të shekullit 21:***

*Shekulli 21 është kohë e ndryshimeve të mëdha e të shpejta në çdo sferë të jetës dhe arsimit nuk bën përjashtim.*

*Shumë nga ne nuk i duam ndryshimet. Ne ndihemi rehat me praktikën, zakonet dhe përditshmërinë tonë. Ndryshimet mund të na duken si kërcënim. Megjithatë, ndryshimi mund të jetë interesant dhe të na ofrojë mundësi të reja..*

*Në këtë pjesë flitet për pesë fusha të jetës shkollore në të cilat ndryshimi është i dukshëm:*

- *Kurrikula*
- *Mësimdhënia dhe të nxënit*
- *Vlerësimi*
- *Teknologjia*
- *Klasa*

*Kjo synon të ju ofrojë një pasqyrë të disa metodave, teorive dhe terminologjisë moderne dhe të sigurojë ndërlidhje me pjesë të tjera për lexim. Shpresojmë se do të ju ndihmojë ta kuptoni thellësinë e ndryshimit që po ndodh në arsim dhe të ju inkurajojë të zbuloni dhe mësoni edhe më shumë.*

## 1.1 “Pse duhet të ndryshojnë shkollat?”



**Pse njerëzit vazhdojnë të thonë se arsimi duhet të ndryshojë për t’i plotësuar nevojat e shekullit 21? Dhe çka do të thotë saktësisht “ndryshim”?**

Ndryshimi i përfshin të gjithë, e megjithatë ende askush nuk e ka përgjigjen e saktë. Bota sot është një nga përgjigjet më të shumëfishta dhe mundësitë e pafundme. Duket si “hallakamë” dhe të provuarit dhe të bërit e gabimeve është thelbësor. Megjithatë, është me rëndësi të mësojmë si të jetojmë dhe punojmë në këtë kohë.

**Siç ndryshon bota në të cilën jetojmë, ashtu duhet të ndryshojnë edhe kurrikula dhe shkollat tona ...**

**Sepse fëmijët tanë nuk kanë zgjedhje!**



**Ndryshimi po ndodh në nivel global**



**Ndryshimi po ndodh në Kosovë**

- **Ndryshim ekonomik**, pasi që Kosova po fokusohet në zhvillim ekonomik
- **Ndryshim politik**, pasi që synon drejt anëtarësimit në BE
- **Ndryshim shoqëror**, pasi që po lëviz drejt një shoqërie më të barabartë dhe gjithpërfshirëse



## Ndryshimi po ndodh në sistemin tonë arsimor?

- **Menaxhmenti arsimor** po decentralizohet.
- **Kurrikula** është e bazuar në kompetenca (me theks në shkathtësi dhe qëndrime si edhe në njohuri).
- **Planifikimi arsimor** po lëviz drejt **ndryshimit sistematik** (shih katrorin në faqen xxx) përmes shfrytëzimit të Education Management Information System (EMIS) dhe nivelit komunal e planifikimit vjetor shkollor.
- **Kompjuterizimi** ofron mundësi të reja dhe interesante të të nxënësve si dhe sfida të ndryshme.
- **Zhvillimi profesional i mësuesve** gjithashtu është duke ndodhur në nivel shkollor.

## Ndryshimi po ndodh në shkollë?



Në faqen tjetër do t'i shikojmë 5 elementet kryesore të ndryshimit në klasë:

- **Kurrikula në ndryshim:** Njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet
- **Pedagogjia në ndryshim:** Mësimdhënia me nxënësin në qendër
- **Vlerësimi në ndryshim:** Standardet dhe etika
- **Teknologjia në ndryshim:** Kompjuterizimi, TIK-u dhe teknologjia edukative
- **Ndryshimi i klasës:** organizimi dhe menaxhimi i klasës

## 1.2 Kurrikula e Kosovës: Kurrikula e Shekullit 21

### Jeta në Shoqërinë e Shekullit 21

Për shkak të ndryshimeve në shoqëri, edhe ne duhet t'i rishikojmë qëndrimet dhe shkathtësitë shoqërore që mësohen në shkollat tona.

Ne duhet të zhvillojmë qëndrime të përshtatshme për qytetarët e shekullit 21

- Barazia gjinore
- Vetëdija për mjedisin
- Toleranca dhe të kuptuarit multi-kulturor
- Vetëdija për sigurinë në internet
- Nxënës të interesuar për mësim gjatë gjithë jetës

**Në Evropë**, Komisioni Evropian i ka zhvilluar "Kompetencat themelore për një shoqëri të bazuar në njohuri" të cilat i përcaktojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e shekullit 21. Këto mund të gjenden në raportin e KE 2004.

### Puna në Vendet e Punës së Shekullit 21

Për një kohë, industrialistët dhe njerëzit e biznesit janë ankuar se sistemi arsimor nuk po nxjerr student me njohuri, shkathtësi dhe qëndrime për vendet e punës në ditët e sotme.


*Në Kosovë, shumë të rinj dështojnë për të gjetë punë sepse i ngatërrojnë shkathtësitë e tyre me nevojat e tregut të punës.*

**Në SHBA**, kompanitë e mëdha si Intel Corporation, Adobe Systems, Apple, Cisco Systems, Dell, Ford, Hewlett Packard, LEGO, Microsoft, Oracle, u bashkuan me Shoqatën Kombëtare të Edukimit për ta formuar Partneritetin për shkathtësitë e Shekullit 21.

[www.p21.org](http://www.p21.org)

### Korniza për të Nxënit në Shekullin 21

Partneriteti për Shkathtësitë e Shekullit 21 ka zhvilluar një vizion të unifikuar dhe të përbashkët për të nxënit e shekullit 21 që mund të përdoret për ta fuqizuar edukimin amerikan. Elementet kryesore të të nxënit të shekullit 21 paraqiten në grafikun dhe përshkrimin vijim. Grafiku prezanton edhe rezultatet e studentëve për shkathtësitë e shekullit 21, (të paraqitura me shigjetat e ylberit) dhe sistemet e përkrahjes për shkathtësitë e shekullit 21 (të paraqitura në pjesën e poshtme):



## KORNIZA E KURRIKULIT TË KOSOVËS E BAZUAR NË KOMPETENCA

Në gusht 2011, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me përkrahje të Komisionit Evropian e finalizoi Kornizën e Kurrikulit (KKK) duke i detajuar kompetencat bazë të qasjes së re të mësimdhënies dhe të nxënësve. Në fjalën e tij hyrëse Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i referohet kalimit nga kurrikuli i bazuar në njohuri në atë të bazuar në kompetenca kështu që rinia e Kosovës të mund të konkurojë në ekonominë globale së bashku me moshatarët e vet në Evropë dhe më gjerë<sup>1</sup>. Më tutje, thuhet se KKK është një përgjigje ndaj sfidave me të cilat ballafaqohet Kosova dhe qëllimi i saj është të themelohet "baza për ngritje të cilësisë dhe barazisë në shërbimet edukative për të gjithë nxënësit; dhe të ndërlihet sistemi arsimor me trendet dhe çështjet që lidhen me reformat momentale të arsimit në sisteme të tjera përparimtare"<sup>2</sup>. Është theksuar edhe nevoja për "të rinjtë zhvillojnë kapacitetet për t'i përdorur njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet në kontekst të zgjidhjes së problemeve në kontekst real"<sup>3</sup>. Përfundimisht principi i parë i artikuluar nënvizon zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulit si mësimdhënie dhe mësimnxënie me nxënës në qendër dhe gjithpërfshirjen<sup>4</sup>.

Gjashtë kompetencat të cilat pritet që nxënësit t'i arrijnë në fund të shkollës së mesme.



Gjashtë kompetencat kryesore	Rezultatet përfundimtare
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; Nxënësit do të jenë të aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të komunikojnë dhe të shprehën përmes gjuhëve, simboleve, shenjave dhe shprehjeve artistike;</li> <li>të angazhohen dhe kontribuojnë në dialoge produktive;</li> <li>të dëshmojnë aftësi për të respektuar rregullat dhe për të qenë kreativ.</li> </ul>	1. Komunikues efektiv
<p><b>2. Kompetenca e të menduarit; Nxënësit do të jenë të aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të mësojnë, kuptojnë, analizojnë, gjykojnë, sintetizojnë; zgjidhin probleme, vlerësojnë dhe vetë-vlerësojnë;</li> <li>të zhvillojnë të menduarit e konceptuar dhe arsyetimin e shëndoshë;</li> <li>të marrin vendime të bazuara në informata të verifikuara;</li> <li>të lidhin vendimet me pasojat;</li> </ul>	2. Mendimtar kreativ
<p><b>3. Kompetenca e të mësuarit; Nxënësit do të jenë të aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të dëshmojnë zotësi të mirëfilltë në lexim, shkrim, matematikë, shkencë, teknologji të informacionit e të komunikimeve dhe qytetari aktive;</li> <li>të dinë si të mësojnë;</li> <li>të identifikojnë dhe përpunojnë informacionet në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.</li> </ul>	3. Nxënës i suksesshëm
<p><b>4. Kompetenca që ka bëjë me punën, jetën dhe mjedisin; Nxënësit do të jenë të aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të punojnë në ekupe;</li> <li>të dëshmojnë shkathtësi organizative dhe udhëheqëse;</li> <li>të dëshmojnë aftësi ndërmarrëse;</li> <li>të zotërojnë aftësi për menaxhim të konflikteve dhe vlerësim të rreziqeve;</li> <li>të ndërmarrin veprime efektive, të përgjegjshme dhe të pavarura;</li> <li>të kontribuojnë në mënyrë efektive në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.</li> </ul>	4. Kontribues produktiv
<p><b>5. Kompetenca personale; Nxënësit do të jenë të aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të dëshmojnë njohje për vetën dhe të tjerët;</li> <li>të dëshmojnë vetëbesim;</li> <li>të menaxhojnë (vetëkontrollojnë) emocionet dhe stresin;</li> <li>të shfaqin bashkëndjesi për të tjerët;</li> <li>të dëshmojnë aftësi për të siguruar jetë të shëndetshme;</li> <li>të bëjnë zgjidhje të përgjegjshme për shëndet, ushtrime trupore dhe shmangie të shprehive dhe substancave të rrezikshme.</li> </ul>	5. Individ i shëndoshë
<p><b>6. Kompetenca qytetare; Nxënësit do të jenë të aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të kuptojnë dhe vlerësojnë diversitetin,</li> <li>të dëshmojnë tolerancë dhe respekt për të tjerët;</li> <li>të dëshmojnë interesim për çështjet publike dhe për pjesëmarrje të përgjegjshme qytetare;</li> <li>të përkrahin dhe nisin ndryshimet e dobishme për jetën e tyre, shoqërinë dhe mjedisin.</li> </ul>	6. Qytetar i përgjegjshëm

(për ta shkarkuar KKK, shko në [www.masht-gov.net](http://www.masht-gov.net))

# SHKATHËSITË

## Basic Education Program

Përmes punës në grupe, nxënësit zhvillojnë shkathësitë e komunikimit, kreativitetin dhe e pranojnë mendimin e njëri tjetrit. Gjatë punës në grupe ata kuptojnë rolet e tyre në grup. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin përmes aktiviteteve konkrete.



të menduarit kritik



vetëvlerësimi



puna grupore



udhëheqësia

### KOMPETENCAT KRYESORE TË KURRIKULËS SË KOSOVËS

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE TË SHPREHURIT  
(Komunikues efektiv)

KOMPETENCA E TË MENDUARIT (Mendimtar kreativ)

KOMPETENCA E TË MËSUARIT (Nxënës i suksesshëm)

KOMPETENCA QË KA TË BËJË ME PUNËN, JETËN DHE MJEDISIN  
(Kontribues Produktiv)

KOMPETENCA PERSONALE (Individ i shëndoshë)

KOMPETENCA QYTETARE (Qytetar i përgjegjshëm)



të lexuarit

# E SHEKULLIT 21

Ata do të zhvillojnë ndërmarrësi, do të zhvillojnë dhe respektojnë oraret, dorëzimin e projekteve në kohë, do ta mësojnë procesin dhe rezultatet. Përdorimi i pajisjeve të shekullit 21 do t'u ndihmojë nxënësve të përgatiten për jetë dhe punë.

## SHKATHTËSITË RELEVANTE TË BASIC EDUCATION PROGRAM

### LEGJENDA

-  të menduarit kritik
-  vetëvlerësimi
-  puna grupore
-  të lexuarit
-  TIK-u
-  të zgjidhurit e problemit
-  kreativiteti
-  hulumtimi
-  ndërmarrësia
-  udhëheqësia
-  gjuha e huaj



TIK-u



të zgjidhurit e problemit



kreativiteti



ndërmarrësia



gjuha e huaj



hulumtimi

## 1.3 Pedagogjia e Shekullit 21

### Mësimdhënia me Nxënësin në Qendër

Mësimdhënia me Nxënësin në qendër kërkon angazhim më të madh edhe nga nxënësit e edhe nga mësimdhënësit. Nxënësi duhet të jetë mendues dhe hulumtues më aktiv përderisa mësimdhënësi duhet të bëhet fasilitator dhe mentor në vend se burim i informatave.



Dallimet në mes të mësimdhënies tradicionale dhe mësimdhënies me nxënësin në qendër mund të shihen në tabelën në vijim:

Mësimdhënësi në Qendër	Nxënësi në Qendër
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Theksi është në mësimdhënësin dhe mësimdhënien</li> <li>• Theksi është në atë që di mësimdhënësi për lëndën</li> <li>• Mësimdhënësi flet; nxënësit dëgjojnë</li> <li>• Nxënësit punojnë vetëm</li> <li>• Mësimdhënësi monitoron dhe përmirëson secilën përgjigje nga nxënësi</li> <li>• Mësimdhënësi u përgjigjet pyetjeve të nxënësve në lidhje me temën apo përmbajtjen</li> <li>• Mësimdhënësi i zgjedh temat</li> <li>• Mësimdhënësi vlerëson dhe evaluon të nxënësit e nxënësve</li> <li>• Klasa është e qetë dhe ka rregull</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Theksi është edhe në nxënësin edhe në mësimdhënësin me theksin kryesor në mësimdhënie</li> <li>• Theksi është në të mësuarit e nxënësve si të mësojnë dhe si të gjejnë informata</li> <li>• Mësimdhënësi ofron model; nxënësit ndërveprojnë me mësimdhënësin dhe me njëri-tjetrin</li> <li>• Nxënësit punojnë në çifte, në grupe, apo të vetëm varësisht nga qëllimi i aktivitetit</li> <li>• Nxënësit flasin pa monitorim të vazhdueshëm të mësimdhënësit; mësimdhënësi ofron informatë kthyesë përmirësim kur parashtrohen pyetje</li> <li>• Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të njëri-tjetrit, duke shfrytëzuar mësimdhënësin apo internetin si burim i informatave</li> <li>• Nxënësit kanë mundësi të zgjedhin një pjesë të temave</li> <li>• Nxënësit e vlerësojnë të nxënësit e vetvetes; mësimdhënësi gjithashtu vlerëson dhe evaluon</li> <li>• Klasa shpesh herë është e zhurmshme dhe plot aktivitet</li> </ul>

#### Mësimdhënësi si nxënësi

Informatat dhe njohuria shkencore po zgjerohen aq shpejt sa që asnjë mësimdhënësi nuk mund t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve të nxënësve. Tekstet ekzistuese dhe librat tjerë nuk duket se mund t'i kenë përgjigjet. Mësimdhënësit duhet të bëhen një lloj i ri i 'ekspertëve' – ekspert në **gjetjen** e informatave. Kjo nënkupton të bëhen shfrytëzues të internetit.

Mënyra tjetër për të mësuar është përmes hulumtimit në veprim. Kjo është një mënyrë për të provuar metoda të reja të mësimdhënies në mënyrë të kontrolluar për të mësuar nga përvojat vetanake.

#### Mësimdhënësit duke mësuar së bashku

Përderisa njohuritë po ndryshojnë dhe po shtohen, për mësimdhënësit është bërë më e rëndësishme të jenë një hap me zhvillimet e reja në lëndët e tyre si përmes hulumtimit individual, p.sh. përmes internetit, ashtu edhe përmes bisedës me mësimdhënësit të tjerë.

Në shkolla dhe komunitete të jashtme të të nxënësit si ekipet për zhvillim profesional, këshillet apo shoqatat lëndore, dhe faqet apo e-platformat në internet mund tu mundësojnë mësimdhënësit të mësojnë nga njëri-tjetri.

### Konstruktivizmi

Hulumtimi thekson se mësimdhënia tradicionale nuk është në harmoni me mënyrën se si truri mëson më së miri. Ai e vë theksin në metodat e mësimdhënies të cilat u ndihmojnë nxënësve të mësojnë më mirë dhe të bëhen nxënës më të shëndetshëm dhe më të lumtur për jetë. Për shembull, e dimë se:

- truri i proceson pjesët dhe tërësitë në mënyrë simultane;
- të gjithë ne jemi të motivuar për ta kërkuar kuptimin;
- kërkimi i kuptimit ndodh përmes modeleve dhe është thelbësisht i ndikuar nga ndjenjat;
- ne kemi forma të ndryshme të kujtesës; dhe
- secila pjesë e trurit është e organizuar në mënyrë të veçantë dhe më shumë.

Kur truri është plotësisht i angazhuar atëherë nxënësit marrin më shumë se njohuri sipërfaqësore të memorizuara. Ata marrin njohuri që është dinamike – atë lloj të njohurisë që nxitet në mënyrë të natyrshme dhe spontane nga ndërveprimet autentike në botën reale.

### Përfshirja kuptimplotë e nxënësve

Përfshirja kuptimplotë e nxënësve është proces i angazhimit të nxënësve si partnerë për qëllim të fuqizimit të zotimit të tyre ndaj arsimimit, komunitetit dhe demokracisë.



**Cikli i Përfshirjes Kuptimplotë të Nxënësve është** proces i vazhdueshëm prej pesë-hapash.

- 1. Dëgjo** – I detë, njohuritë, përvoja dhe opinionet e nxënësve shkëmbehen me të riturit.
- 2. Valido** – Nxënësit njihen si partnerë të qëllimshëm dhe të rëndësishëm në shkollë.
- 3. Autorizo** – Nxënësit kontribuojnë në përmirësimin e shkollës përmes shkëmbimit të shkathtësive, planifikimit të veprimit dhe pjesëmarrjes strategjike.
- 4. Mobilizo** – Nxënësit dhe të riturit ndërmarin veprime së bashku si partnerë në përmirësimin e shkollës, përmes një llojllojshmërie të metodave.
- 5. Reflekto** – Të riturit dhe nxënësit së bashku analizojnë çka kanë mësuar përmes krijimit, zbatimit dhe përkrahjes së përfshirjes kuptimplotë të nxënësve, duke përfshirë dobitë dhe sfidat. Reflektimet pastaj përdoren për ta informuar Hapin 1, Dëgjo.

### Jo aq e re!

Edhe përpara kemi mësuar se si funksionon truri, shumë mësimdhënës e kanë ndjerë në mënyrë instiktive se fëmijët kanë nevojë të mësojnë duke bërë. Mund ta dini proverben kineze:

- **Unë dëgjoj, unë harroj,**
- **Unë shoh, unë mbaj mend**
- **Unë bëj, unë kuptoj**

Dhe tani mund të shtojmë: *praktikoj, mundem.*

Një qasje praktike e bazuar në projekte është përdorë nga filozofi dhe edukatori, John Dewey, në fillim të shekullit XX. Në 1970-tat, shkenca e arsimit është transformuar në Angli nga një projekt i shkencës së klasave 5-13 i cili përdori një qasje praktike me fëmijën në qendër.

## 1.4 Vlerësimi për Nxënie

### VLERËSIMI ËSHTË MË SHUMË SE NOTIMI!

Vlerësimi i mirë është:

- Monitorim i të nxënësve të nxënësve;
- Shkëmbimi i informatave në lidhje me të nxënësve;
- Vlerësimi i të nxënësve dhe gjërave të mësuara;
- Dhënia e udhëzimeve për të nxënësve në të ardhmen;
- Mbajtja e të dhënave dhe dokumentimi i zhvillimit dhe të arritjeve të nxënësve.



Vlerësimi i mirë duhet tu ndihmojë nxënësve të mësojnë më mirë duke:

... siguruar informatë kthyesë të saktë dhe duke u ndihmuar nxënësve ta përmirësojnë të kuptuarit dhe të vendosin caqe të qarta.



Vlerësimi i mirë duhet tu ndihmojë mësimdhënësve për mësimdhënie më të mirë duke:

... identifikuar keqkuptimet dhe duke u ndihmuar mësimdhënësve ta modifikojnë mësimdhënien dhe të ofrojnë aktivitete përmirësuese



### Vlerësimi është për nxënie

Për tu siguruar se vlerësimi u ndihmon nxënësve të mësojnë sigurohu që vlerësimi të fillojë ditën e parë të shkollës dhe se është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve gjatë gjithë kohës.



Ndiqe rrethin:

#### Bëjeni së bashku me nxënësit.

Përfshirja e nxënësve në vlerësim është thelbësore për të nxënësve të tyre. Mund ta përdorni vetë-vlerësimin dhe vlerësimin e bashkëmoshatarëve.

**Çka është vetë-vlerësimi?** Është metodë e vlerësimit në të cilën nxënësit e vlerësojnë procesin e tyre të të nxënësve, duke përfshirë përcaktimin e kriterëve të suksesit dhe vlerësimin e vetes se sa i kanë arritur kriteret e përcaktuara.

**Çka është vlerësimi i bashkëmoshatarëve?** Është metodë e vlerësimit të nxënësve nga nxënësit tjerë në mënyrë që të ngritet të kuptuarit e tyre të qëllimeve të cilat duhet të arrihen, të ngritet të nxënësve dhe të nxënësve të menduarit kritik dhe shkathtësitë e komunikimit.

### Vlerësimi i bashkëmoshatarëve nga nxënësit



Luljeta Rama nga shkolla fillore Eqrem Çabej në Mitrovicë fasilitoi një orë mësimore me nxënësit e saj të klasës së pestë me temën, *Mbretëria e Dardanisë së vjetër*. Në fillim të orës ajo i udhëzoi nxënësit për kriteret që do të përdoren për ta matur të nxënësve të tyre gjatë orës. Pas prezantimit të përmbajtjes së mësimin, nxënësit punuan në çifte për t'iu përgjigjur pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësja të cilat pastaj u kaluan te një çift tjetër i nxënësve të cilët pastaj i vlerësuan përgjigjet duke iu referuar librave të tyre.



### **Metoda të ndryshme të vlerësimit për qëllime të ndryshme**

Vlerësimi duhet të sigurojë informata relevante për të nxënësit nga e kaluara dhe për të ardhmen dhe në të njëjtën kohë të jetë efikas dhe interesant. Planifikimi dhe zgjedhja e metodave të vlerësimit është i rëndësishëm.

Duhet të jeni të vëmendshëm për:

- Llojin e informatave që dëshironi të mbledhni;
- Metoda e vlerësimit duhet të jetë në pajtim me stilin e punës dhe duhet të jetë e lehtë për tu përdorur;
- Tu shpjeguar nxënësve tuaj çka dëshironi të kuptoni dhe si do ta përdorni atë informatë;
- T'ua mundësoni nxënësve t'i shprehin të arriturat e tyre në mënyrën më të përshtatshme për stilin e tyre të të nxënësit; dhe
- Përdorimin e TIK-ut sa herë që është e mundur – nxënësit kanë dëshirë t'i japin përgjigjet duke e përdorur kompjuterin; dhe do të jetë më e thjeshtë edhe për ju.

Nga testuesi dhe vlerësuesi, roli juaj ndryshon në atë të personit i cili vëzhgon, monitoron, dëgjon, pyet, pret përgjigje, bisedon, ofron vetë-besim.

### **Vetë-vlerësimi i nxënësve**



*Nxënësit e klasës së katërt të shkollës Dardania në Prishtinë ishin duke mësuar për kubet. Mësimdhënësja e tyre, Merita Vokri, u dha nxënësve të saj një projekt për ta prerë formën e kubit dhe për ta ngjyrosur secilën anë me ngjyra relevante. Në fund të orës, mësimdhënësja kërkoi nga nxënësit ta vlerësojnë punën e tyre duke i përdorë kriteret e suksesit që u ishin dhënë në fillim të orës. Duke e përdorë teknikën "Semafori" nxënësit e vlerësuan veten.*



### **Keni parasysh çështjet emocionale dhe ndjenjat e nxënësve kur u jepni informatë kthyesë**

Hulumtimet tregojnë se nxënësit nuk mund të mësojnë mirë kur janë të shqetësuar. Është me rëndësi që mësimdhënësi t'i marrë parasysh ndjenjat e nxënësve kur u jep informatë kthyesë ashtu që të ketë rezultat pozitiv nga informata kthyesë.

Hulumtimet gjithashtu tregojnë se vetë-besimi pozitiv dhe motivimi i mirë janë çelësi i suksesit të nxënësve. Është me rëndësi të jepet informatë kthyesë pozitive si edhe të theksohen gabimet.



## 1.5 Teknologjia në Përkrahje të të Nxënimit & Zhvillimit të Shkathtësive



### Çka ka në dispozicion?

#### Kompjuterët në shkolla

Shumica e shkollave në Kosovë kanë kompjuterë - qoftë laboratore të reja të laptopëve mobil ose laboratorë statik me kompjuterë tavoline. Njëzet e katër komuna janë pajisur me klasa të shekullit 21 në të cilat kanë qasje të gjitha shkollat e komunës. Këto klasa kanë laboratorë mobil të kompjuterëve të cilët përmbajnë 15 net-book-ë dhe 5 laptopë të rregullt, qasje në internet, kabinë lëvizëse për mbajtjen dhe mbushjen e laptopëve dhe mjete të tjera të ndryshme (p.sh. kuti kontrolluese, mikroskop, krah robotik). Njëzet shkolla të tjera kanë laboratorë kompjuterik me 32 laptopë dhe qasje në internet. Të gjithë laptopët kanë licencë për sistemin operativ Windows 7 dhe softuerin MS Office. Përveq kësaj janë edhe dyzet shkolla të tjera që kanë laboratorë kompjuterik dhe platformë elektronike të të nxënimit të testuara.

#### Softuer i hapur (Open-space)

Paketa të hapura edukative të softuerit përdoren në shkolla për lëndë të ndryshme. Për shembull, FMS Logo përdoret në matematikë. Burime të tjera edukative online dhe softuerë përdoren në shkolla duke përfshirë: ALICE, një softuer animacioni 3D me të cilin nxënësit mësojnë bazat e programimit JAVA, Google Sketchup një softuer dizajni 3D, Geogebra dhe Microsoft Mathematics dhe Greenfoot, një softuer krijues. Burime tjera të dobishme mund të gjenden në:

- [www.technologystudent.com](http://www.technologystudent.com)
- [flexmath.ck12.org](http://flexmath.ck12.org)
- [phet.colorado.edu](http://phet.colorado.edu),
- [www.khanacademy.org](http://www.khanacademy.org)

#### Kompjuterët janë më të dobishëm kur u shtohen mjetet ndihmëse

**Printerët:** U mundësojnë nxënësve dhe mësuesve të printojnë produktet e veta.

**Projektorët:** Video projektorët mund të përdoren në masë të gjerë për prezantime në klasë, trajnime në klasë dhe ngjarje të tjera.

**Robotët:** Robotë të programuar e angazhojnë kureshtjen dhe dëshirën e natyrshme të nxënësve për zbulim. Disa, për nxënësit e rinj, mund të përdoren pa ndihmën e kompjuterit dhe kanë pulla të thjeshta grafike që mundëson kontrollimin nga fëmijët e vegjël. Robotë më të sofistikuar programohen duke i përdorë kompjuterët.


**Kutitë kontrolluese:** Kutia kontrolluese është një mjet i thjeshtë për përdorim i cili u mundëson nxënësve t'i kontrollojnë modelet e jetës reale nga kompjuteri dhe të mbledhin informata nga sensorët.

**Kamerat:** Kamera digjitale me kosto të lirë mund të incizojnë imazhe, ose si fotografi apo si imazhe lëvizëse për projekte. Mund të përdoren edhe telefonat mobil

**Mikroskopët:** Mikroskopët kompjuterik mund të kapin dhe xhirojnë imazhe dhe video në kompjuter. Duke i shikuar imazhet mikroskopike për nxënësit e vegjël është shumë më lehtë pasi që mund t'i shohin në ekran. Përdorimi i projektorit e mundëson theksimin e karakteristikave para tërë klasës

**Kalkulatorët & Mjetet tjera:** Kalkulatorët grafik janë mjete mësimi të dizajnuara për tu ndihmuar nxënësve t'i vizualizojnë konceptet dhe për të bërë ndërlidhje në matematikë dhe shkencë. Në kombinim me mjete dhe sensorë të tjerë ato e kthejnë një klasë të zakonshme në një mjedis modern të të nxënimit dhe laborator shkencor.

## Si mund ta përdorim teknologjinë?



### Hulumtimi në internet në klasë

Interneti i zgjeron burimet që janë në dispozicion për mësimdhënësit dhe nxënësit dhe zvogëlon vartësinë në kohë dhe lokacion që mund të jenë faktorë kufizues në shkollë. Ai ofron mënyra të fuqishme dhe të llojllojshme për nxënësit dhe mësimdhënësit për të ndërvepruar, manipuluar të dhëna dhe për të bërë hulumtime. Interneti nuk është qasje në arsim, por më tepër është një mjet që mund të përdoret me pothuajse çdo metodologji të mësimdhënies. Ai i vë në dispozicion burime të tjera shtesë; e ngrit komunikimin dinamik; dhe e bën bashkëpunimin më të lehtë duke e zvogëluar nevojën që njerëzit të jenë në të njëjtën kohë në vendin e njëjtë.

Nxënësve duhet tu mësohen rregullat dhe etikën e 'sigurisë në internet' për tu siguruar që do të kenë përvojat më të mira arsimore.



### Klubet e Nxënësve për Përkrahje Teknike (SSTC): një studim rasti për përfshirje kuptimplotë të nxënësve

SSTC-të janë grupe të nxënësve të klasave të shtata dhe teta të cilët përkujdesen për infrastrukturën hardverike të shkollës, bëjnë menaxhim bazik të rrjetit dhe u ndihmojnë mësimdhënësve gjatë përdorimit të përditshëm të kompjuterëve. Secila shkollë fillore që ka kompjuterë e ka edhe një SSTC i cili vepron nën udhëheqjen e dy mësimdhënësve mbikqyrës. SSTC u ofron nxënësve mundësi të ndërtojnë shkathtësi teknike dhe të zgjidhjes së problemeve përditshme në të njëjtën kohë u ndihmojnë mësimdhënësve ta përfshijnë teknologjinë në orët e tyre duke siguruar përkrahje teknike në vend. Roli të cilin e kanë luajtur teknikët nxënës gjatë ndihmës së mësimdhënësve të cilët nuk kanë njohuri për teknologjinë ka qenë veçanërisht i rëndësishëm.

## 1.6 Klasa e shekullit 21



### Klasa e përshtatshme për fëmijë

Thjesht lëvizja e mobileve dhe rimodelimi i klasës nuk është i mjaftueshëm; nevojitet një raport i ri me nxënësit. Kërkoni nga nxënësit të propozojnë rregulla & procedura për klasën.

Përfshini nxënësit në përgatitjen e dizajneve për rregullimin e klasës duke përdorë tabela me katrorë në letër apo kompjuter. Sigurohuni që të gjithë nxënësit ndihen të mirëseardhur.

### Përfshirja e Prindërve dhe Komunitetit

Prindërit duhet të jenë të mirëseardhur në klasë si vizitorë apo persona burimor.

Emëroni një këshill të klasës të udhëhequr nga një prind për dekorimin dhe pajisjen e klasës.



### Kompjuterët dhe TIK-u

Vendosni kompjuterët në atë mënyrë që të mund të përdoren në mënyrë fleksibile nga grupe të vogla si edhe nga individë.

Lejoni hapësirë përreth kompjuterëve për mjete tjera siç është mikroskopi digjital.

Hartoni rregulla për përdorimin e kompjuterëve, duke përfshirë sigurinë në internet. Vendosini në vend të dukshëm.

### Mësimi i diferencuar

Në klasën e shekullit 21, nxënësit mund të punojnë në detyra të ndryshme. Ky mësim i diferencuar është shumë i dobishëm kur nuk ka hapësirë apo mjete të mjaftueshme brenda klasës; mësimdhënësi u ofron ndihmë apo sfida shtesë një grupi të vogël.



## Plani i Klasës

Përdorni letër table për ta vizatuar planimetrinë e klasës tuaj. Preni copa të letres me ngjyrë për t'i përfaqësuar mobilet dhe lëvizni përreth për ta gjetur dizajnin që ju përshtatet më së miri.

Përfshijini nxënësit tuaj në këtë punë dizajni. Ky është një aktivitet matematikor i mrekullueshëm - një mënyrë e dobishme për ta praktikuar matjen dhe vizatimin në shkallë zvogëlimi.

## Si e dizajnuan nxënësit e mi klasën e tyre

Nexhmije Foniqi, mësuese në shkollën 17 Shkurti në Banjë të Malishevës, i përfshiu nxënësit e vet në dizajnimin e klasës së tyre gjatë përgatitjeve për renovimin e klasës.



## Krijimi i panove efektive

Panotë mund të japin ide, ta përqendrojnë vëmendjen, t'i motivojnë nxënësit, të ofrojnë informata dhe ta festojnë suksesin.

Tabelat mund të krijohen me çmim shumë të ulët nga tablo stiropori - mbulohen me material me ngjyrë - do të zgjasin më gjatë dhe do të duken më bukur.

Gjilpërat apo ngjitëset janë mënyrë e lirë për ta vendosur letrën në tabelë; ato duken më mirë se gjilpërat me kokë plastike.

...Përdorni një mjet interneti për ta dizajnuar klasën tuaj në kompjuter në p.sh  
**[www.floorplanner.com](http://www.floorplanner.com)**



## Qendrat e të nxënit të organizuara sipas lëndëve

Organizimi i klasës në qendra të të nxënit ndihmon në krijimin e një klase me fëmijën në qendër e cila promovon zgjedhjen e nxënësve, hulumtimin, përgjegjësinë personale, bashkëpunimin, komunikimin dhe respektin. Qendrat e aktiviteteve të të nxënit mund të fokusohen në: lexim dhe shkrim, matematikë, shkencë, art, kompjuterë dhe dramë/lojë kreative. Për më shumë informata shih Doracakun për Renovimin e Klasës.

**Mbani mend, çelësi është të filloni me një ose dy qendra dhe të shtoni të tjera kur të jeni gati ju dhe nxënësit.**

## Organizimi i klasës në shkollat me disa ndërrime

Rregullime të ndryshme të klasës mund të nevojiten për grup moshë dhe lëndë të ndryshme. Kështu që, në rastet kur paraqitet nevoja për ta ndarë klasën, do të ishte mirë të mos ndahen ndërrimet në nivel fillor dhe të mesëm të ulët.

Mësuesit duhet të kenë takime të rregullta për t'i koordinuar panotë. Në klasë mund të caktohen tabela specifike për grupe të ndryshme të nxënësve.

Inkurajimi i mësimdhënësve për t'i shikuar panotë e njëri-tjetrit mund t'i mbajë standardet e larta dhe të gjenerojë ide të reja.

Rregullat duhet të përfshijnë "leni klasën ashtu si e keni gjetur ose edhe më mirë".



## 2. Aspekte të mësimdhënies dhe të nxënies në shekullin 21

### Të dashur mësimdhënës të shekullit 21

*Në këtë pjesë, do të hasni llojlojshmëri të koncepteve edukative, qasje të mësimdhënies dhe ide. Shumë nga to mund të jenë të njohura për ju dhe mund të jeni duke i përdorur tashmë.*

*Kjo pjesë u jep informata bazike me 'tema' dyfaqëshe për të dhënë përmbledhje të shkurtër të këtyre aspekteve. Mund të lexoni më shumë online në 'Arkën e Thesarit' apo ta konsultoni fjalorin në pjesën 1.*

*Do të shihni se shumë qasje bashkëkohore të mësimdhënies, si "të nxënies e bazuar në projekte" dhe "të nxënies e bazuar në probleme" kanë karakteristika të ngjashme. Ato mund të përfshijnë:*

<b>Aktivitete grupore</b>	...për të zhvilluar shkathtësi sociale dhe të punës në ekip që janë thelbësore në vendet moderne të punës.
<b>Detyra shtesë</b>	... që vazhdojnë për një periudhë kohore më të gjatë
<b>Detyra autentike</b>	... ku nxënësit zgjidhin probleme të jetës reale
<b>Mendim kreativ</b>	... për krijimin e zgjidhjeve inovative
<b>Mendim kritik</b>	... për analizimin e problemeve dhe marrjen parasysh të mundësive
<b>Hulumtim i pavarur</b>	... ku nxënësit përdorin llojlojshmëri të burimeve për të gjetur informata

*Metodat e ndryshme mund të jenë të dobishme për klasë të ndryshme, lëndë të ndryshme dhe tema të ndryshme. Ju jeni gjykatësi më i mirë për atë që është më efektive në zhvillimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të cilat u nevojiten nxënësve në shoqërinë e shekullit 21.*

**Zgjidhni atë që është më e përshtatshme për ju dhe nxënësit tuaj!**

## 2.1 Çka është qasja e bazuar në temë?

Është një qasje ndaj mësimdhënies që përfshin integrimin e disa lëndëve në një temë për një kohë të caktuar. Ajo shkon përtej kufijve lëndor dhe u ndihmon fëmijëve t'i ndërlidhin shkathtësitë themelore akademike me ide të botës reale..

### Karakteristikat tipike të qasjes së bazuar në temë janë:

#### Integrimi i lëndëve

Një numër lëndësh (p.sh. leximi, matematika, shkenca, lëndët shoqërore dhe arti) kombinohen në një temë duke lejuar që përmbajtja dhe shkathtësitë të mësohen në kontekst përmbajtësor.

#### Mësimi i diferencuar

Ndihmon integrimin e modaliteteve dhe stileve të ndryshme të të nxënësve si dhe të grupimit strategjik të nxënësve bazuar në nevojat e identifikuara.

#### Fokusi autentik

Nxënësit mësojnë informatat relevante dhe e zbatojnë atë njohuri në skenarë të jetës reale.

#### Interesimet e nxënësve

Temat mund të nxiren nga kurrikula apo të bazohen në interesimet e nxënësve. Përfshirja e nxënësve në zgjedhjen e temave krijon interesim dhe një ndjenjë të përgjegjësisë për të nxënësit e tyre.

### Pse të përdoret qasja e bazuar në tema? Cilat janë dobitë?

- **Motivimi** - Temat të cilat u interesojnë nxënësve apo adresojnë çështje të jetës reale e zgjojnë kureshtjen e nxënësve gjë që i motivon nxënësit të mësojnë më shumë dhe të përfitojnë përvoja.
- **Të nxënësit në kontekst** - U ndihmon nxënësve të kuptojnë atë që mësojnë (pjesë të tërësisë) dhe ta zbatojnë përmbajtjen në mënyrë përmbajtësore.
- **Shkathtësitë si edhe përmbajtja** - Përkrah zhvillimin e shkathtësive të nxënësve si punën ekipore, komunikimin dhe mendimin kritik; gjithashtu përkrah bashkëpunimin dhe njëtrajtësinë e grupit.
- **Planifikimi i mësimdhënësit** - Ndihmon planifikimin ditor pasi që zhvillohet njësi tematike. Përgjegjësia për gjetjen e temave dhe ideve mund të ndahet me nxënësit.

### Çka ndryshon nga të nxënësit tradicional?

Mësimdhënësi merr vendime për përmbajtjen.	Përfshihen nxënësit dhe mësimdhënësit.
Përmbajtja lëndore mësohet përmes lëndës.	Qasja gjithpërfshirëse që bën ndërlidhje dhe e prezanton 'tërësinë'; bëhen ndërlidhje.
Mësimdhënësi planifikon në bazë ditore dhe lëndore.	Mësimdhënësi e planifikon temën dhe nxjerr njësi ditore nga tema.



## Si duket qasja tematike ndaj të nxënimit?

Mësuesja e klasës së tretë Rajmonda Kurshumlija nga shkolla fillore Yll Morina në Gjakovë shpesh herë e përdor qasjen tematike ndaj të nxënimit ku e integron gjuhën shqipe, matematikën, shkencën, muzikën dhe artin në një temë javore. Tema e dytë e vitit të cilën e prezanton Rajmonda zakonisht është "stina e vjeshtës". Ajo e planifikon javën duke i përcaktuar njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet të cilat duhet t'i mësojnë dhe marrin nxënësit në secilën fushë lëndore dhe pastaj i harton rezultatet e të nxënimit për atë javë. Pastaj Rajmonda i mbledh burimet dhe materialet për ta përkrahur të nxënimit e nxënësve. Gjatë javës nxënësit mësojnë për stinën e vjeshtës, ndryshimet në natyrë, ndryshimet klimatike dhe veshmbathjen e nevojshme për t'iu përshtatur këtyre ndryshimeve. Ata gjithashtu mësojnë për pemët dhe perimet që rriten duke përfshirë matjen dhe njësitë që duhen përdorë.



Disa nga aktivitetet në të cilat u angazhuan Rajmonda dhe nxënësit gjatë vjeshtës së kaluar përfshijnë:

- **E hënë:** Diskutim rreth vjeshtës dhe leximi i tregimit "Vjeshta e artë"; zgjidhja e disa problemeve matematikore dhe punim arti me materiale të riciklueshme me temë "kopshti në vjeshtë".
- **E martë:** Shkruajnë për pemët dhe perimet që rriten gjatë vjeshtës; mësojnë për njësitë e matjes që përdoren për t'i matur ato; këndojnë këngën "Vjeshta".
- **E mërkurë:** Stuhi mendimesh për ndryshimet në natyrë dhe diskutim pse ndodhin ato; lexim i poezisë "Gjethet e vjeshtës"; vazhdim i punës për njësitë matëse; dhe lojë me role "Largimi nga foleja".
- **E enjte:** pas hulumtimit, nxënësit shkruajnë për të mirat në vjeshtë; vizitojnë tregun e afërt për të mësuar rreth blerjes dhe shitjes së pemëve dhe perimeve; dhe bëjnë vizatimin "Pemët në vjeshtë".
- **E premte:** Rishikojnë çka kanë mësuar në lidhje me vjeshtën; parashetrojnë pyetje për gjërat që do të donin të dinin më shumë për vjeshtën në Kosovë, fillojnë të mbledhin të dhëna; këndojnë këngën "Shiu".

## Si e bëj qasjen tematike ndaj të nxënimit të suksesshme?

### 1. Planifikoje mirë

- Vendos për temën dhe lëndët që do të integrohen. Temat mund të merren nga literatura për fëmijë, përmbajtja kurrikulare, ngjarjet momentale apo nga ato që zgjedhen nga nxënësit.
- Përcakto afatin kohor për temë – një javë, një muaj apo më gjatë varësisht nga tema.
- Përcakto përmbajtjen, shkathtësitë dhe qëndrimet – harto rezultatet e të nxënimit.
- Stuhi mendimesh për aktivitetet që i përkrahin ato.

### 2. Mbledh materialet dhe burimet

- Mbledh libra dhe materiale tjera leximi (mos i harro nxënësit dhe komunitetin si burime)
- Kërko në internet për burime dhe lojëra
- Siguro material shpenzues (p.sh. ngjyra të ujit); mos harro të mbledhësh material të riciklueshëm.

### 3. Organizoj qendrat dhe grupimin e nxënësve

- Bëj një plan të qendrave të aktivitetit dhe rregullo hapësirën fizike të klasës.
- Ndaji nxënësit në grupe mësimi duke u bazuar në nevojat e të nxënimit dhe të tjera që duhet marrë parasysh
- Vendos rregulla për punë në grupe së bashku me nxënësit.

### 4. Vendos për mjetet për vlerësim para se të fillosh

- Dosjet dhe vlerësimi i bazuar në performancë ofrojnë mënyra për vlerësimin e të nxënimit përmes qasjes së bazuar në temë.
- Mënyrat tjera përfshijnë vëzhgimin e nxënësve gjatë punës grupore, prezantimeve me gojë dhe posterëve.
- Vetë-vlerësimi dhe vlerësimi i bashkëmoshatarëve të punës ekipore dhe shkathtësive tjera mund të përdoren gjithashtu për ta vlerësuar të nxënimit.

## 2.2 Të nxënit përmes lojës konstruktive

### Çka është të nxënit përmes lojës konstruktive?

Të nxënit përmes lojës konstruktive është kur aktivitetet e lojës përdoren për të kontribuar në zhvillimin e nxënësve - qoftë në fushën emocionale, fizike, intelektuale apo shoqërore.

Loja është një nga komponentat thelbësore të zhvillimit të fëmijëve. Në vitet e para të shkollimit, nxënësit vazhdojnë ta hulumtojnë botën përmes përvojave indirekte si tregimet, fotografitë dhe programet televizive. Informatat e marra në këtë mënyrë bëhen bazë për lojë imagjinare e cila i dërgon fëmijët përtej të këtushmes dhe tashmes. Aktivitetet e lojës si vizatimi, ndërtimi me blloqe, vallëzimi, muzika dhe punëdorja u ndihmojnë fëmijëve t'i zgjerojnë njohuritë dhe të kuptuarit e botës përderisa e zhvillojnë koordinimin sy-dorë dhe shkathtësitë tjera motorike. Përderisa nxënësit kalojnë në vitet e para të shkollimit fillor, fokusi kalon nga loja dramatike (edhe pse loja me role ende mbetet më e afërta) apo loja imagjinare në 'lojëra me rregulla' dhe sporte të organizuara të cilat kërkojnë strategji dhe shkathtësi. Lojërat me rregulla përfshijnë lojëra tradicionale tabelë, karta, video dhe lojëra kompjuterike si dhe lojëra fizike si tag. Përmes këtyre përvojave të lojës, fëmijët i zhvillojnë aftësitë e tyre në raport me të tjerët, shkathtësitë e tyre motorike dhe koordinimin e tyre sy-dorë. Përderisa nxënësit kalojnë në nivelin e mesëm të ulët, loja u ndihmon t'i refinojnë aftësitë e tyre për arsye, mendim strategjik dhe ndërveprim me të tjerë. Këto shkathtësi zhvillohen përmes aktiviteteve të lojës si sporte të organizuara, punëdore, sete të avancuara ndërtimi, projekte shkencore, sajuese të sofistikuar dhe lojëra kompjuterike dhe video lojëra.

### Karakteristikat tipike të të nxënit përmes lojës konstruktive:

- *Aktivitete të cilat janë të sigurta, gjithpërfshirëse dhe jo të dhunshme;*
- *Përvoja që nxisin nxënësit të zhvillojnë shkathtësi dhe marrëdhënie pozitive;*
- *Mundësi që i inspirojnë nxënësit të mësojnë më shumë për veten dhe botën rreth tyre;*
- *Aktivitete që inkurajojnë kreativitetin dhe ndihmojnë zhvillimin e personalitetit të nxënësve; dhe*
- *Përvoja që e bëjnë të nxënit kënaqësi.*

### Pse të përdoret loja për ta përkrahur të nxënit? Cilat janë dobitë?

- *Loja siguron kontekst përmbajtësor për nxënësit të mësojnë koncepte dhe shkathtësi;*
- *Loja e bën të nxënit të jetë kënaqësi dhe kështu e nxit interesimin dhe motivimin;*
- *Loja i inkurajon nxënësit të hulumtojnë dhe zbulojnë së bashku dhe të vetëm;*
- *Loja siguron mundësi për mësimnxënie bashkëpunuese me të rriturit dhe moshatarët dhe kështu e përkrah menaxhimin e klasës;*
- *Loja i inkurajon nxënësit të eksperimentojnë dhe të rrezikojnë;*
- *Loja siguron mundësi për nxënësit t'i praktikojnë shkathtësisë; dhe*
- *Loja e përkrah mësimin e diferencuar pasi që mësimdhënësi është i liruar për të punuar me grupe të vogla të nxënësve për arsye specifike.*



### Si duket loja konstruktive?

Mësuesja Albana Dujaka nga shkolla fillore Mustafa Bakija në Gjakovë ndjeu përgjegjësi për nxënësit e saj të klasës së parë përderisa vinin e ktheheshin nga shkolla çdo ditë. Përderisa dëshironte që ata t'i kuptojnë rreziqet potenciale në trafik, në të njëjtën kohë nuk dëshironte që t'i frikësojë andaj vendosi ta përdorë lojën si qasje për të nxënëit e nxënësve. Ajo e filloi mësimin me një diskutim për përvojat e tyre kur vijnë dhe kthehen nga shkolla që i nxitin të tregojnë ku e kalojnë rrugën dhe nëse ka semaforë në ato vende. Tregimet e nxënësve zbuluan se disa nga nxënësit nuk dinin çka të bënin kur ndizej drita me ngjyrë të verdhë. Loja e sajuar nga Albana ishte që nxënësit të mblidhen në rreth me një nxënësi në mes i cili kishte tri letra me ngjyrë që përfaqësonin ngjyrat e semaforit. Pastaj nxënësit filluan të lëvizin përpara si grup dhe nëse nxënësi e mbante lart letrën e kuqe, atëherë nxënësit i ngritnin duart lart dhe ndalonin. Kur nxënësi e mbante lart letrën e verdhë, nxënësit e ngritnin njërin dorë dhe fillonin të ecnin më shpejt. Atëherë kur nxënësi e ngrite letrën e gjelbër, nxënësit shikonin në të dy anët, i ngritnin të dyja duart dhe lëviznin përpara.

### Si ta bëj të suksesshëm të mësuarit përmes lojës?

1. *Adopto një qasje pedagogjike që përdor metoda të mësimdhënies dhe të nxënëit që janë ndërvepruese, praktike dhe të këndshme;*
2. *Kalo nga roli i dhënësit të njohurive (mësimdhënie) në atë të fasilitatorit, udhëzuesit apo drejtuesit (të të nxënëit).*
3. *Sigurohu që nxënësit të kenë përvoja praktike të ndërlidhura me situata të jetës reale;*
4. *Krijo përvoja të bazuara në interesime të fëmijëve;*
5. *Gjej një mënyrë për të siguruar materiale të llojllojshme duke përfshirë bashkëpunimin me prindër dhe komunitet (sigurohu që materialet janë të përshtatshme për moshën e nxënësve);*
6. *Përqendrohu në lojëra dhe aktivitete të tjera që e inkurajojnë bashkëpunimin në vend të garimit. Nëse përdor gara, mendo për mënyra ku të gjithë mund të fitojnë; dhe*
7. *Kur është e përshtatshme, bashkangjitju lojës me nxënësit.*

## 2.3 Mësimi autentik

### Çka është mësimi autentik?

Një qasje në të cilën nxënësit hulumtojnë, punojnë në një detyrë dhe zgjidhin probleme të jetës reale, duke përdorë metoda dhe mjete të ngjashme me profesionistët e vërtetë.

#### Karakteristikat tipike të mëimit autentik janë:

<b>Detyrat autentike</b>	<i>Nxënësit mësojnë përmes aktiviteteve që kërkohen në rolin e hulumtuesve, shkrimtarëve, aktorëve dhe profesionistëve të tjerë në jetën 'reale'.</i>
<b>Aktivitetet grupore</b>	<i>Shpesh herë nxënësit punojnë në çifte apo grupe siç do të bënin në jetën 'reale'.</i>
<b>Loja me role</b>	<i>Nxënësit mund të punojnë në role, si për shembull në një situatë grupore nxënësit mund të veprojnë si redaktorë, kameramanë, drejtorë, kostumografë, etj.</i>
<b>Fasilitimi i mësimdhënësit</b>	<i>Roli i mësimdhënësit është t'i drejtojë nxënësit në procesin e të nxënimit, t'u ndihmojë në sigurimin e burimeve dhe lidhjeve me komunitetin përreth.</i>
<b>Të nxënimit përmes përvojës *</b>	<i>Nxënësit mësojnë drejtpërdrejtë nga përvojat të cilat i përjetojnë dhe ka më shumë mundësi mos ta harrojnë atë që mësojnë.</i>

### Pse të përdoret mësimi autentik? Cilat janë dobitë?

1. Nxënësit janë më të motivuar nga problemet reale që janë të përshtatshme për ta. Ky motivim i brendshëm i bën ata të punojnë më shumë dhe të fokusohen më shumë në të nxënimit e tyre.
2. Të nxënimit është i ndërlidhur me botën 'reale' jashtë klasës ku nxënësit angazhohen në vëzhgime, eksperimente dhe zgjidhje të problemeve.
3. Nxënësit punojnë në detyra komplekse ku kërkohen procese më të larta të menduarit (analizë, sintezë, dizajn, manipulim, vlerësim dhe krijim).
4. Nxënësit zhvillojnë shkathtësi për vlerësimin e të nxënimit të tyre, shkathtësive për vetë-avancim dhe shkathtësi për mësim gjatë tërë jetës..

### Çka është ndryshe nga të nxënimit tradicional?

Probleme të shkollës tradicionale	Problema autentike
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyrat janë nga tekstet shkollore</li> <li>• Problemet janë shpesh abstrakte pa kontekst specifik.</li> <li>• Problemet janë të thjeshta dhe u mungon thellësia si dhe zgjidhja është e shpejtë.</li> <li>• Ato përfshijnë aktivitete garuese dhe përgjegjësia është individuale.</li> <li>• Problemet janë zakonisht artificiale dhe nuk janë shumë relevante për nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyrat janë të bazuara në kontekste të jetës reale.</li> <li>• Problemet janë reale dhe nxënësit janë të angazhuar në përcaktimin dhe zgjidhjen e tyre.</li> <li>• Problemet kanë thellësi dhe kompleksitet më të madh si dhe zgjidhja e tyre zgjat më shumë.</li> <li>• Ato përfshijnë aktivitete bashkëpunimi dhe përgjegjësia ndahet.</li> <li>• Problemet janë reale dhe dobitë nga të nxënimit kanë vlerë të madhe për nxënësit..</li> </ul>

## Si duket mësimi autentik?

Në shkollën fillore Asdreni në Pejë, nxënësit së bashku me mësimdhënësen e tyre, Hidajete Nikqi, e vërejtën se lulet në oborrin e shkollës së tyre të cilat ishin mbjellur disa javë më herët nuk po rriteshin siç kishin pritur. Ata dukeshin të vyshkura dhe dukej se do të thaheshin; por arsyeja e tharjes nuk ishte mungesa e ujit. Ata vendosën ta zgjidhin këtë problem; të zbulojnë se çka po ndodhte dhe pse. Ata diskutuan për problemet e ndryshme; hulumtuan çka e shkakton secilin problem me lulet; pastaj menduan ide se si ta zgjidhin këtë problem. Nxënësit ishin të vendosur t'i shkonin deri në thelb problemit dhe ta gjenin çka e shkaktonte vyshkjen dhe tharjen e luleve, në mënyrë që oborri i shkollës së tyre të ketë lule të bukura dhe të shëndosha.



Nxënësit i morën lulet nga oborri dhe i analizuan. Ata përdorën enë të ndryshme laboratorike dhe teknologjike. Në një eksperiment, ata e vendosën lulen në menzurë, dogjën sulfur anash dhe e mbuluan me këmbanë. Pas një kohe, ata vërejtën se ngjyra e lules po zbehej dhe se lulja filloi të thahej. Përmes këtij eksperimenti, ata erdhën në përfundim se djegia e mbeturinave afër oborrit po ndikonte në lule. Ata shkuan te drejtori i shkollës për të parë se çka mund të bënin në lidhje me djegien e mbeturinave pasi që ata kishin mësuar edhe për ndikimin që ka në mjedis.

## Si ta bëj mësimin autentik të suksesshëm?

### 1. Planifiko mirë

- Përderisa i definon qëllimet e të nxënësve, vendose theksin në përmirësimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve, vetë-vlerësimin dhe aftësimin e nxënësve "si të mësojnë", si një nga kompetencat kryesore për jetën e tyre tash dhe në të ardhmen.
- Dizajnimi i detyrave autentike duhet të ndërlidhet me përmbajtjen dhe rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në kurrikulë si edhe me jetën jashtë shkollës.

### 2. Vendos si do t'i vlerësosh nxënësit para se të fillosh

Në mësimin autentik, theksi i vlerësimit vëhet në aplikimin e njohurive të marra dhe shkathtësive në situata të jetës reale. Ai përfshin mënyra të ndryshme të demonstrimit të asaj që është mësuar.

- Produktet dhe puna finale e nxënësve (p.sh. raportet e hulumtimit, analiza e ngjarjeve, esetë, posterat, broshurat, tekstet e botuara në revista).
- Interpretimi dhe demonstrimi (fjalimet në publik, mbajtja e intervistave, dramatizimi).
- Shkathtësitë e procesit (mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve) dhe sjellja
- Reflektimi/retrospektiva kritike në të nxënësve personal (p.sh. ditar, dosje)

Lexo më shumë në 'Arkën e Thesarit' →

### \*Mësimi autentik ndonjëherë shoqërohet me Edukimin nga Përvoja

Edukimi nga përvoja është një filozofi dhe metodologji në të cilën edukatorët sigurojnë përvoja direkte për nxënësit dhe e ndihmon reflektimin në mënyrë që të ngritet njohuria, të zhvillohen shkathësi dhe të qartësohen vlerat. Kjo filozofi bazohet në besimin se nxënësit do ta mbajnë mend më mirë mësimin kur ai bazohet në përvojën direkte. Kjo mund të përmbledhet me një proverb kineze:

**"Unë dëgjoj, unë harroj; Unë shoh, unë harroj; Unë bëj, unë kuptoj"**

Lexo më shumë në uebfaqen e Asociacionit për Edukim Eksperimental: [www.aee.org](http://www.aee.org)

## 2.4 Lojë me role: Përdorimi i dramës

### Çka është loja me role?

Nxënësi merr qëndrimet, veprimet dhe rrjedhën e dikujt tjetër, sidomos në situatë joreale, në përpjekje për t'i kuptuar këndvështrimet e ndryshme apo ndërveprimet shoqërore. Personazhi mund të jetë imagjinar, real apo historik.

Karakteristikat kryesore të lojës me role:

<b>Detyrat autentike</b>	<i>Nxënësit mësojnë përmes aktiviteteve që kërkohen në rolin e hulumtuesve, shkrimtarëve, aktorëve apo profesionistëve nga jeta 'reale'.</i>
<b>Aktivitetet grupore</b>	<i>Nxënësit shpesh punojnë në çifte apo në grupe siç ndodh edhe në jetën 'reale'.</i>
<b>Karakterizimi</b>	<i>Nxënësit mund të marrin role të personazheve specifike, si në dramë.</i>
<b>Empatia</b>	<i>Duke e vënë veten në pozitë të tjetrit, nxënësit mund t'i kuptojnë të tjerët më mirë.</i>
<b>Fasilitimi i mësimdhënësit</b>	<i>Roli i mësimdhënësit është të ndihmojë në krijimin e kontekstit real, shpesh duke marrë pjesë edhe vetë me ndonjë rol, dhe duke ofruar udhëzime për t'i mbajtur nxënësit në rol.</i>

### Pse të përdoret loja me role? Cilat janë dobitë?

- Promovon të nxënësit aktiv, punën ekipore, bashkëpunimin dhe ndërveprimin në mes nxënësve;
- Siguron mundësi për gjetjen e burimeve në situata të paparashikuara;
- Inkurajon përdorimin e mendimit kritik dhe analizën e problemeve kur të merret roli i dikujt tjetër dhe reflektimin se si mund të mendoj personazhi;
- Ndhmon zhvillimin e shkathtësive të nxënësve në fushën emocionale (shih 'Arkën e Thesarit' – Taksonominë e Blumit);
- Mund t'ju ndihmojë nxënësve t'i kuptojnë të tjerët më mirë duke e marrë rolin e personazheve nga kultura tjera apo nga historia;
- Siguron mundësi kreative për përfshirjen e nxënësve në detyra dhe situata të jetës 'reale';
- Mundëson zbatimin praktik të njohurive nga nxënësit në situata të ndryshme;
- Ndhmon nxënësit të zhvillojnë iniciativën, shkathtësitë e komunikimit, zgjidhjen e problemeve, vetëdijen dhe bashkëpunimin përmes punës grupore; dhe
- Mund tu ndihmojë nxënësve të jenë më të përgatitur në tejkalimin e sfidave të "botës reale".

### Çka ndryshon nga të nxënësit tradicional?

Mësimdhënia tradicionale	Loja me role
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit janë të ulur dhe pasiv</li> <li>• Nxënësit punojnë individualisht</li> <li>• Imagjinata dhe kreativiteti i nxënësve shpesh nuk sfidohen</li> <li>• Problemat janë 'të bazuara në shkollë'</li> <li>• Fokusi është në njohuritë akademike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit janë aktiv</li> <li>• Nxënësit punojnë në çifte apo grupe</li> <li>• Imagjinata dhe kreativiteti janë shkathtësitë kryesore</li> <li>• Problemet janë të bazuara në jetën jashtë shkollës</li> <li>• Lejon demonstrimin e talenteve tjera të nxënësve</li> </ul>

## Si duket loja me role?



Mësimdhënësi i gjuhës angleze, Ruzhdi Krasniqi, nga shkolla Selman Riza në Fushë Kosovë shpesh e përdor lojën me role me nxënësit e vet. Ai e konsideron atë veçanërisht të dobishme për përkrahjen e nxënësve në zhvillimin e gjuhës angleze dhe shkathtësive tjera. Përvoja e tij tregon se nxënësit nuk ngurojnë të flasim në gjuhën angleze kur bëjnë sikur janë dikush tjetër. Ruzhdiu e ka vërejtë gjithashtu se shumica e nxënësve të klasës së nëntë nuk e dinë se cilat lëndë janë të nevojshme për profesione apo veprimtari të ndryshme. Nga nxënësit u kërkua të përcaktojnë cilën karrierë dëshirojnë ta ndjekin dhe në bazë të kësaj t'i formojnë grupet. Atëherë ata hulumtuan për kërkesat për kariera të ndryshme dhe zhvilluan një lojë me role për t'i demonstruar profesionet/veprimtaritë dhe njohuritë e shkathtësitë e nevojshme. Nxënësit tjerë patën mundësi të parashtronjë pyetje. Ruzhdiu vërejti se në fillim nxënësit e patën të vështirë të qëndrojnë në rol, sidomos nëse nxënësit tjerë qeshnin me moshatarët e tyre apo thonin ndonjë fjalë, kështu që ai i bëri këto aspekte pjesë të kriterëve të suksesit të vlerësimit për nxënie.

## Si ta bëj lojën me role të suksesshme?

### 1. Merrni me seriozitet

- Pajtohuni me rregullat për lojën me role para se të filloni. Bëjini të qarta pritshmëritë tuaja.
- Në fillim, nxënësit mund të ndihen të ndruajtur apo jo rehat në marrjen e rolit dhe ndoshta do tu duhet t'i inkurajoni të qëndrojnë në rol. Tërhiqni vërejtjen vëzhguesve të reagojnë vetëm ashtu siç do të reagonin në situatën aktuale.
- Mbajeni aktivitetin e lojës me role të shkurtër për fillim; theksoni sa e rëndësishme është për nxënësit të qëndrojnë në rol. Lavdërojini shumë nxënësit të cilët qëndrojnë në rol. Tregojuni pse po i lavdëroni.
- Merrni pjesë me ndonjë rol edhe ju. Nëse ju e merrni me seriozitet, ashtu do të bëjnë edhe nxënësit.
- Pasi që nxënësit të ndihen më rehat me rolin e tyre, ata mund ta shtojnë edhe humorin dhe improvizimet përderisa qëndrojnë në rol.

### 2. Planifiko mirë

#### Përcakto qëllimet

- Cilat njohuri, shkathtësi dhe qëndrime dëshironi t'i arrijnë nxënësit?

#### Zgjedh kontekstin dhe rolet

- Identifiko kontekstin dhe karakteret. Hulumto për vete por identifiko mënyra se si nxënësit mund t'i zbulojnë këto informata vetë. (Libra, internet, filma, etj.)

#### Prezanto ushtrimin

- Prezanto situatën para nxënësve në një mënyrë interesante.
- Thuaje atë që pret nga nxënësit dhe çka pret të mësojnë ata.
- Jepu udhëzime për hulumtim.
- Ndaji nxënësit në ekipe.

#### Nxënësit punojnë në përgatitje dhe hulumtim

- Nxënësit njoftohen me personazhet dhe rolet e zgjedhura.
- Ata bëjnë një plan hulumtimi dhe kërkojnë burime të ndryshme për informatat e nevojshme.
- Ata shkruajnë skenarë, bëjnë kostume dhe prova.

#### Loja me role

- Nxënësit i praktikojnë rolet e tyre në mënyrë individuale dhe si grup.
- Nxënësit e prezantojnë lojën me role.
- Loja me role mund të xhirohet në mënyrë që nxënësit të mund ta vlerësojnë interpretimin e tyre.

#### Vlerësimi dhe evaluimi

- Diskutim të hapur nga nxënësit.
- Skenarët e përgatitur nga nxënësit mund të vlerësohen nga moshatarët duke përdorur një listë kontrolluese të bazuar në kriteret e përcaktuar të suksesit.
- Nxënësit mund të shkruajnë ese reflektuese të cilat mund të vlerësohen.
- Prezantimet mund të vlerësohen gjithashtu, (Sa kanë qëndruar mirë në rol? Sa janë artikulluar qartë çështjet kryesore?)

## 2.5 Strategjitë për mendim kritik

Mendimi kritik nuk mund të mësohet përmes ligjëratave. Mendimi kritik është proces aktiv, dëgjimi i ligjëratave, shumicën e kohës është aktivitet pasiv. Shkathtësitë intelektuale të mendimit kritik – analiza, krijimi, reflektimi, etj. – duhet të mësohen përmes praktikimit aktual të tyre. Prandaj udhëzimet në klasë, detyrat e shtëpisë, hartimet dhe provimet duhet ta theksojnë pjesëmarrjen aktive intelektuale të nxënësve.

### Mendimi kritik

Ne mund tu ndihmojmë nxënësve tanë të mendojnë në mënyrë kritike – të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë në mënyrë të sigurtë, t'i dëgjojnë të tjerët dhe t'i analizojnë mendimet duke u bazuar në fakte. Të gjithë mendojnë; megjithatë, mendimi ynë mund të jetë i njëanshëm, i çorientuar, i pjesshëm, i painformuar apo paragjykes. Megjithatë cilësia e jetës tonë si edhe ajo që prodhojmë, bëjmë apo ndërtojmë varet nga cilësia e mendimeve tona. Mendimi i pamatur apo i pamenduar kushton, si në cilësi të jetës ashtu edhe në të holla.

***“Mendimi kritik është ajo formë e të menduarit – për cilëndo lëndë, përmbajtje apo problem – në të cilën menduesi e përmirëson cilësinë e të menduarit të tij apo saj përmes zotërimit të shkathtë të strukturave apo elementeve (p.sh. qëllimit, problemit, apo ështëjes; supozimet; konceptet) të trashëguara në të menduar apo përcaktimin e standardeve intelektuale për ta.”***

[www.criticalthinking.org](http://www.criticalthinking.org)

### Një mendues kritik:

- parashtron pyetje dhe probleme vitale, duke i formuluar qartë dhe saktë;
- mbledh dhe vlerëson informata përkatëse, duke përdorur ide abstrakte për t'i interpretuar në mënyrë efektive, nxjerr përfundime dhe zgjidhje të arsyetuara mirë – duke i testuar ato përmes kriterëve dhe standardeve përkatëse;
- mendon në mënyrë të hapur në kuadër të sistemeve alternative të mendimit duke i njohur dhe vlerëzuar, sipas nevojës, supozimet, implikimet dhe pasojat praktike; dhe
- komunikon me të tjerët në mënyrë efektive për të gjetur zgjidhje për probleme komplekse.

### Parashtrimi i Pyetjeve

**Si mund të parashtror pyetje të cilat janë nxitëse ndaj të menduarit më të thellë dhe kritik në vend të të menduarit sipërfaqësor?**

Në mënyrë që t'i zhvilloni shkathtësitë e nxënësve të të menduarit të nivelit më të lartë (aftësinë e tyre për të parashikuar, vënë hipoteza dhe arsyetuar), mësimdhënësi duhet të parashtror pyetje të cilat janë nxitëse ndaj të menduarit të thellë në vend të të menduarit sipërfaqësor. Është me rëndësi që të:

- Reflektoni për llojet e pyetjeve të cilat i përdorim gjatë orës mësimore;
- Jepni modelin e pyetjeve dhe të menduarit që dëshironi nxënësit tuaj ta mësojnë; dhe
- Planifikoni orën mësimore në të cilën do të përdorni llojllojshmëri të llojeve të pyetjeve (jo vetëm të nivelit literal apo pyetje faktike).

**Duke parashtruar pyetje të përshtatshme, ne mund ta zhvillojmë aftësinë e nxënësve për të:**

- Parashikuar;
- Reflektuar për të menduarit e tyre;
- Vëzhguar më thellë;
- Vënë hipoteza;
- Parë nevojën për dëshmi;
- Arsyetuar

**... duke parashtruar pyetje si:**

- “Çka mendon se do të ndodhë?”
- “Pse mendon ashtu?”
- “Çka ke parë tjetër?”
- “Çka dëshiron të vërtetosh?”
- “Si mund ta vërtetosh atë?”
- “Çka të ka drejtuar në këtë përfundim?”



Përdorimi i Taksonomisë së Blumit mund t'ju ndihmojë t'i zgjidhni më mirë pyetjet. **Për më shumë informata konsultoni 'Arkën e Thesarit' online apo Udhëzuesin e MASHT-it (të përkrahur nga BE) për Praktikën e Përmirësuar të Klasës.**

### Teknikat për diskutimin e problemeve dhe sfidave

Ndonjëherë, mësimdhënësit duhet të jenë të gatshëm të thonë **“Nuk e di përgjigjen në këtë pyetje.”** dhe të kërkojnë ndihmën e nxënësve për ta gjetur përgjigjen për pyetjen në fjalë. Teknikat për diskutim që janë të paraqitura në vijim mund të përdoren:

**Stuhi mendimesh** është një teknikë grupore kreative e dizajnuar për të gjeneruar numër të madh idesh për zgjidhjen e një problemi. Nxënësit duhet të japin ide sa më shpejt që është e mundur. Ato shënohen në një tabelë dhe pastaj përcaktohet kriteri në bazë të të cilit mbahen ose eliminohen idetë. Pastaj, mund të bëhet një hartë e koncepteve. Stuhia e mendimeve mund të përdoret për të zgjidhur probleme të cilat janë identifikuar nga mësimdhënësi ose nga nxënësit. Është pikë fillestare e mirë për prezantimin e problemeve para tërë klasës. Ajo mund ta ngritë kënaqësinë e punës dhe ta përmirësojë punën ekipore.

**Koha në rreth** që mbahet me rregull siguron kohë për të dëgjuar, për ta rritur përqendrimin, promovuar komunikimin me gojë dhe për mësimin e koncepteve dhe shkathtësive të reja. Ajo e përfshin tërë grupin të ulur në rreth për të diskutuar çështje të ndryshme. Rregulla kryesore është se vetëm një person mund të flasë në kohë kur ai/ajo e mban një objekt të caktuar. Mbajtja e këtij objekti për të folë nënkupton se të gjithë të tjerët duhet të dëgjojnë. Rregullat (përfshirë edhe udhëzimet për kohën për secilin nxënës) për kohën në rreth duhet të diskutohen me nxënës dhe të pajtohen të gjithë.

**Disutimi në grup të vogël** ofron më shumë mundësi për secilin nxënës të merr pjesë në diskutim. Nxënësit të cilët janë më të nguruar për t'i shprehur idetë në grup të madh mund të:

- mendojnë me zë dhe të ndërmarrin rrezik duke siguruar ide 'jashtë kutisë';
- bëhen nxënës me më shumë vetëbesim;
- zhvillojnë shkathtësitë e gjuhës së folur si nxënës pasi që idetë e tyre për aktivitete vlerësohen; dhe
- përmirësojnë raportet e tyre me nxënësit tjerë dhe me mësimdhënësit e tyre.

Grupi mund të raportojë më vonë para tërë grupit për t'i shkëmbyer idetë e tyre.



## 2.6 Vlerësimi për nxënie

### Çka është vlerësimi për nxënie?

Vlerësimi në shkolla tradicionalisht është përdorë për qëllime raportimi dhe është bërë pasi që ka ndodhur të nxënësve. Për shembull, nxënësve u janë dhënë nota në fund të vitit apo kanë hyrë në test për tu vlerësuar për atë që kanë mësuar. Ky lloj vlerësimi, i cili e përmbledh arritjet e nxënësve për një kohë të caktuar, quhet **vlerësim sumativ**<sup>5</sup>, apo vlerësimi I të nxënësve.

Megjithatë, nëse informatat për të nxënësve përdoret si informatë kthyesë në mënyrë që mësuesit dhe nxënësit ta përmirësojnë mësuesin dhe të nxënësve në të ardhshëm atëherë ky vlerësim bëhet **vlerësim formativ** apo vlerësim PËR nxënie. Një shembull mund të jetë:

- mësuesi bën pyetje për nxënësit përderisa ata mësojnë,
- si rezultat mësuesi zbulon se nxënësja ka keqkuptuar,
- mësuesi është në gjendje t'i ndihmojë nxënësve që ajo ta përmirësojë keqkuptimin.

Qëllimi kryesor i vlerësimit në shkollë duhet të jetë për të përmirësuar të nxënësve dhe të arriturat e nxënësve. Vlerësimi për nxënie duhet të bëhet nga mësuesit dhe nxënësit për çdo ditë.

### Pse të përdoret vlerësimi për nxënie? Cilat janë dobitë?

Vlerësimi mund ta përmirësojë të nxënësve nëse:

- Siguron informatë kthyesë për nxënësit;
- Udhëheq ndryshimet në mësuesin për ta bërë atë më efektive;
- Ngrit motivimin dhe vetë-respektin e nxënësve, të cilat janë thelbësore për të nxënësve; dhe
- Përfshin në mënyrë aktive nxënësit ashtu që ata të kuptojnë se si mund të përmirësohen.

Vlerësimi efektiv mund të sigurojë të kuptuar më të thellë të progresit të nxënësve në:

- Marrjen e njohurive të reja;
- Zhvillimin e shkathtësive për proces – mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve;
- Ndërtimin e qëndrimeve;
- Zhvillimin e shkathtësive të reja për komunikim me shkrim dhe me gojë; dhe
- Zhvillimin e shkathtësive të punës ekipore.

Në vlerësimin e cilësisë së lartë, **mësuesit** dhe **nxënësit** duhet t'i kenë përgjigjet në pyetjet në vijim:

- Cilat qëllime të të nxënësve duhet t'i arrijnë nxënësit?
- Si po përparon nxënësia drejt këtyre qëllimeve?
- Cilat do të jenë hapat e ardhshëm në mësuesin dhe mësuesin?
- Cilat janë dëshmitë se qëllimet e të nxënësve janë arritur?

### Si duket vlerësimi për nxënie?

Mësuesja e klasës së katërt, Mimoza Osmanaj, nga shkolla Martin Camaj në Istog e ka vërejtur se vendosja e kriterëve të suksesit për nxënës për një 'pjesë' të të nxënës u ndihmon nxënësve në motivim si edhe ndikon në ndjenjën e tyre për drejtësi. Ata kanë dëshirë të dinë se cilat koncepte, shkathtësi apo qëndrime pritet t'i arrijnë para se të fillojnë. Gjatë mësimit për 'diellin, tokën dhe hënën', Mimoza filloi me stuhi mendimesh me nxënësit e saj për atë çka ata dinë për këtë temë dhe i shënoi. Pastaj ata lexuan në mënyrë individuale mësimin në tekstet shkollore duke shënuar me simbole atë që tashmë e dinin dhe informacionin e ri që e kanë mësuar duke vazhduar me diskutimin e udhëhequr nga mësime dhënësja për tu siguruar se të gjitha të dhënat e rëndësishme janë artikuluar. Mimoza shtoi informatat që mungonin. Nxënësit pastaj në mënyrë individuale e bënë një listë të asaj që dinin para mësimit dhe atë që e mësuan gjatë orës mësimore. Mësime dhënësja i lexoi pastaj pikat thelbësore së bashku me nxënësit duke theksuar me anë të teknikës së flamurit nëse kanë qenë në listën e tyre ose jo.



## Si ta bëj të suksesshëm vlerësimin për nxëniet?

### Planifikoje mirë

Vlerësimi është pjesë e procesit të mësime dhënies dhe të nxënësit dhe nuk duhet të paraqesë barrë shtesë për ju apo për nxënësit. Para se të filloni aktivitetin mendoni:

1. Çka dëshiroj të mësojnë nxënësit përmes këtij aktiviteti? Cilat koncepte, shkathtësi, qëndrime? Si do t'i përfshijmë nxënësit në identifikimin e qëllimeve? Si do ta di nëse kanë kuptuar atë që pritet të arrijnë?
2. Si do ta di se nxënësit e kanë arritur atë që është planifikuar që ata ta arrijnë? Cilat do të jenë dëshmitë?
3. Cilat aktivitete, sjellje dhe produkte do t'i vlerësoj? (Përgjigjet me gojë? Diskutimin? Prezantimin? Raportin e hulumtimit? Hartën e koncepteve? Modelin?)
4. Si do t'i regjistroj gjetjet? A më duhen instrumenta të përgatitur? (për shembull, fletë me pikë, lista kontrolluese, dosje)
5. A do t'i përfshij nxënësit në vlerësim dhe, nëse po, si?
6. Si do tu ofroj informatë kthyesë nxënësve? Si do tu ndihmoj të dijnë si të mësojnë më mirë?

### Zbatoje mirë

1. Zhvilloni diskutimet, pyetjet dhe detyrat të cilat do tu ndihmojnë të kuptoni si mësojnë dhe mendojnë nxënësit;
2. Ofroni informatë kthyesë e cila do tu ndihmojë në të nxënësit e mëtutjeshëm;
3. Ndihmojuni të kuptojnë se çka pritet të mësojnë dhe si mund ta vlerësojnë atë që kanë bërë;
4. Mundësoju nxënësve të bëjnë zgjedhje në lidhje me të nxënësit e tyre;
5. Mundësoju atyre të mësojnë nga njëri-tjetrit (puna ekipore, vlerësimi i moshatarëve);
6. Ndihmoju të fitojnë vetë-besim se mund ta përmirësojnë performancën e tyre; dhe
7. Informo prindërit për progresin e fëmijës së tyre ashtu që të mund t'i përkrahin ata.

## 2.7 Vetë-vlerësimi

### Çka është vetë-vlerësimi?

Një metodë vlerësimi në të cilën nxënësit e vlerësojnë procesin e tyre të të nxënimit, pajtohen për kriteret e suksesit dhe qëllimet e të nxënimit me mësimdhënësin dhe vlerësojnë se sa i kanë arritur kriteret e përcaktuara.

### Çka bëjnë nxënësit?

- nxënësit i analizojnë përparësitë dhe mangësitë e asaj që kanë bërë;
- mendoni për atë se si të tejkalohen dobësitë; dhe
- gjatë punës; ata e përdorin përvojën e tyre paraprake.

### Çka vlerësojnë nxënësit?

Produktet më të përshtatshme për vetë-vlerësim janë: puna me shkrim, krijimet praktike (posterët, modelet dhe projektet), detyrat e shtëpisë dhe dosjet.

### Pse të përdoret vetë-vlerësimi? Cilat janë dobietë?

- Nxënësit vetëdijësohen për atë se si mësojnë dhe kjo u ndihmon ta përmirësojnë të nxënimit e tyre;
- Nxënësit bëhen më efikas, me më shumë vetëbesim dhe nxënës të pavarur;
- Nxënësit i kuptojnë më mirë qëllimet e të nxënimit përmes vlerësimit të përparimit të tyre;
- Nxënësit mund t'i dallojnë gabimet e tyre para se të vlerësohen;
- Nxënësit mësohen si të bëhen më reflektues dhe më vetë-kritik në procesin e të nxënimit, kjo u ndihmon ta ngritin cilësinë dhe u mundëson thellësi më të madhe;
- Ai promovon një qëndrim pozitiv drejt të nxënimit dhe zhvillon shkathtësitë e të nxënimit gjatë gjithë jetës;
- Mësimi i lëndës që mësohet përmirësohet; dhe
- Një pjesë e përgjegjësisë për marrjen e vendimeve në këtë proces të të nxënimit transferohet nga mësimdhënësi te nxënësi.



## Si duket vetë-vlerësimi?

Mësuesja e klasës së tretë Bahtie Ahmeti nga shkolla Vellezerit Frasheri në Lipjan kishte dëshirë t'u ndihmojë nxënësve të klasës së tretë t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre për vetë-vlerësim. Pasi që siguroi letër karton, ajo i udhëzoi nxënësit e saj të vizatojnë dhe presin numrat 1, 2 dhe 3; pastaj t'i ngjyrosin ato duke përdorë të kuqen për #1, të portokalltën për #2 dhe të gjelbrën për #3. Pastaj Bahtija u shpjegoi se pas mësimit në matematikë apo lexim për shembull, ajo do t'u kërkojë ta ngritin numrin i cili përfaqëson të kuptuarit e tyre për mësimin:



- #3 nëse e kanë kuptuar mirë dhe janë në gjendje t'ia shpjegojnë atë shokëve të klasës;
- #2 nëse e kuptojnë deri diku, por kanë nevojë për më shumë informata;
- #1 nëse nuk kanë kuptuar.

Gjatë orës së ardhshme në matematikë për relacionin e bashkësive, ajo e provoi këtë teknikë të vetë-vlerësimit nga nxënësit. Duke u bazuar në këto rezultate të vlerësimit të të nxënësve, Bahtije i bashkoi në çifte shumicën e nxënësve për mësime mes bashkëmoshatarëve dhe punoi me grupe të vogla nxënësish të cilët e vlerësuan veten se nuk e kanë kuptuar mësimin.

## Si ta bëj vetë-vlerësimin të suksesshëm?

### Planifiko mirë

Fazat kryesore në realizimin e vetë-vlerësimit janë: përgatitja, zbatimi dhe vlerësimi.

Faza 1 - Përgatitja	Faza 2 - Zbatimi	Faza 3 - Vlerësimi
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifikimi – definimi i qëllimeve të qarta të të nxënësve.</li> <li>• Udhëheqja e nxënësve në procesin e vlerësimit.</li> <li>• Dhënia e udhëzimeve të qarta (me gojë dhe me shkrim) për të gjitha fazat e procesit.</li> <li>• Përcaktimi/definimi i kriterëve të suksesit nga nxënësit (dhe diskutimi me mësuesin për plotësimin e tyre).</li> <li>• Përgatitja e listës së kriterëve të suksesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi i listës së kriterëve të suksesit për punën e vet.</li> <li>• Dhënia e informatës kthyesë për suksesin e nxënësve dhe krahasimi me vetë-vlerësimin.</li> <li>• Nxënësit bëjnë vetë-përmirësim në të kuptuarit e tyre të kriterëve të suksesit.</li> <li>• Përcaktimi i qëllimeve të reja/azhuruara të të nxënësve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutimi dhe analiza/reflektimi me të gjithë nxënësit për vetë-vlerësimin dhe dhënien e informatës kthyesë.</li> <li>• Identifikimi i gjërave që ishin të dobishme dhe identifikimi i dobësive dhe problemeve.</li> <li>• Planifikimi dhe ndërmarrja e hapave për tejkalimin e problemeve.</li> </ul>

Për më shumë informata konsultoni 'Arkën e Thesarit' online. 

## 2.8 Vlerësimi i bashkëmoshatarëve

### Çka është vlerësimi i bashkëmoshatarëve?

Metoda e vlerësimit të nxënësve përmes moshatarëve të tyre në mënyrë që të kuptohen qëllimet e vendosura për të përmirësuar të nxënët dhe për t'i nxitur shkathtësitë e mendimit kritik dhe të komunikimit.

#### Çka bëjnë nxënësit?

Ata japin informatë kthyese për cilësinë e përpjekjeve dhe përgjigjeve të moshatarëve të tyre, si edhe të procesit të të nxënët të tyre.

#### Pse të përdorni vlerësimin e bashkëmoshatarëve? Cilat janë dobitë?

1. Ai i ndihmon nxënësit ta kuptojnë më mirë procesin e vlerësimit dhe e shton motivimin e tyre për të nxënë.
2. Nxënësit i kuptojnë karakteristikat e punës së cilësisë së lartë dhe kjo u ndihmon të bëhen vetë-kritik për punën e tyre;
3. Nxënësit zhvillojnë shkathtësi thelbësore të evaluimit dhe reflektimit që nevojiten për dhënien e informatës kthyese;
4. Informata kthyese u ndihmon nxënësve me procesimin përfundimtar të detyrës dhe i thëllon shkathtësitë e tyre para se të vlerësohen nga mësimdhënësi;
5. Nxënësit tregojnë përgjegjësi dhe pavarësi më të madhe në të nxënët e tyre;
6. Nxënësit u ndihmojnë bashkëmoshatarëve gjatë mësimt;
7. U ndihmon t'i qartësojnë kriteret e vlerësimit;
8. U mundëson t'i praktikojnë shkathtësitë e reflektimit dhe evaluimit të nevojshme për të nxënë gjatë gjithë jetës; dhe
9. Mund ta zvogëlojë sasinë e punës së mësimdhënësit në lidhje me vlerësimin.

### Si duket vlerësimi i moshatarëve?

Gjatë orës së kimisë për masën relative molekulare, nxënësit e klasës së tetë nga shkolla fillore Asdreni në Pejë punuan me mësimdhënësen e tyre për t'i përcaktuar kriteret e suksesit që do të përdoren gjatë vlerësimit të mësimt. Kriteret u fokusuan në njohuri dhe në shkathtësi. Për shembull, ata e bënë një listë të shkathtësive thelbësore të nevojshme për nxënësit në mënyrë që ta përdorin sistemin periodik të elementeve. Nxënësit punuan në grupe për ta përcaktuar se si ta gjejnë masën relative molekulare dhe pastaj matën masën e pesë përbërësve. Në të njëjtat grupe, ata përdorën qasjen kritike për ta vlerësuar punën e njëri-tjetrit. Këta nxënës të klasës së tetë vërejtën se vlerësimi i bashkëmoshatarëve u ndihmoi të angazhohen në mësim dhe ta zgjerojnë të kuptuarit e tyre për njësinë. Disa nxënës thanë se të qenit në pozitën e vlerësuesit i motivoi ta marrin të nxënët e tyre në mënyrë më serioze si dhe të mendojnë në mënyrë më kritike për atë që janë duke bërë.



## Si ta bëj vlerësimin e bashkëmoshatarëve të suksesshëm?

### Planifiko mirë

1. Përcakto çka do të vlerësohet nga nxënësit dhe pse;
2. Zgjedh strategjitë apo teknikat për vlerësimin e bashkëmoshatarëve;
3. Përgatit kriteret dhe format e vlerësimit të cilat do t'i përdorin nxënësit (bëjeni këtë vetë apo me nxënësit); dhe
4. Mendo për strukturën për udhëheqjen e diskutimit në mes të nxënësve dhe për mënyrën e dhënies së informatës kthyese.

Duhet t'i **përgatisni** nxënësit paraprakisht ashtu që tu mundësoni ta marrin rolin e vlerësuesit dhe filloni me **zbatimin**.

### Përgatitja mbulon:

<b>Modelimi/demonstrimi i vlerësimit të bashkëmoshatarëve</b>	Përmes një shembulli të punës së bërë nga një nxënës anonim, ju e udhëhiqni diskutimin, ofroni rishikim kritik të punës dhe përdorni gjuhë të përshtatshme për dhënien e informatës kthyese për cilësinë e punës si edhe për rekomandime.
<b>Praktika e nxënësve</b>	Nxënësit praktikojnë shembullin në mënyrë që të jeni të sigurtë se e kanë kuptuar mmirë mënyrën e vlerësimit dhe udhëheqjen e diskutimit

### Organizoje mirë



<b>Realizimi i vlerësimit të bashkëmoshatarëve</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nxënësit njihen me qëllimet e vlerësimit dhe u jepen udhëzime në pajtim me strategjinë që e keni zgjedhur.</li> <li>2. Përfshini nxënësit tuaj në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.</li> <li>3. Diskutoni për strukturën e diskutimit në mes të nxënësve në lidhje me: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Parashtrimin e pyetjeve të përshtatshme si të regjistohen përgjigjet.</li> <li>• Dhënien e informatës kthyese</li> </ul> </li> <li>4. Nxënësit diskutojnë në mes vete për informatën kthyese dhe notat.</li> </ol>
--	---

## 2.9 Vlerësimi me anë të dosjes së nxënësve

### Çka është vlerësimi me dosje?

Një metodë e vlerësimit të nxënësve duke përdorur një koleksion të organizuar dhe të sistematizuar të punës së nxënësve, gjatë një periudhe të gjatë korore, që përfaqëson përpjekjet, progresin dhe të arriturat e nxënësit në një apo më shumë fushë lëndore.

### Çka përmban dosja e nxënësit?

- **Produkte të ndryshme të cilat demonstrojnë performanca spontane dhe të planifikuara për qëllime të ndryshme (për shembull: punë me shkrim, punë projekti, videoxhirime dhe fotografi).**
- **Kriteret për vlerësimin e punës së krijuar (duke përdorë listën analitike të vlerësimit).**
- **Dëshmi të reflektimit të të nxënësit të nxënësit, duke përfshirë qëllimet e përcaktuara dhe vetë-vlerësimin.**

### Si vlerësohet?

Mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të përfshihen në përcaktimin e përmbajtjes dhe kriterëve për evaluimin dhe përparimin gjatë të nxënësit. Në vlerësimin e dosjes, theksi vihet në evaluimin e përparimit të cilin e arrin nxënësi, procesi dhe shkathtësitë praktike gjatë një periudhe të dhënë kohore. Këtu janë dy lloje të dosjeve:

Dosja zhvilluese dokumenton nivelin/shkallën e të nxënësit dhe siguron dëshmi për përparimin e nxënësve. Zakonisht ajo i referohet vlerësimit formativ, por mund të përdoret edhe për vlerësimin në fund të gjysmëvjetorit apo të vitit shkollor.

Dosja reprezentative demonstroi arritjet më të mira të të nxënësit dhe mbulon punën më të mirë. Ajo përdoret për vlerësim sumativ për shkak të natyrës së tij. Qëllimi është të bëhet evaluimi përfundimtar dhe zakonisht shoqërohet nga prezantimi me gojë i përmbajtjes së mbuluar në dosje.

### Pse të vlerësohet dosja e nxënësit? Cilat janë dobitë?

- **Demonstroi nivel të njohurisë, shkathtësive dhe qëndrimeve të fituara për fushën lëndore;**
- **Siguron mundësi për monitorimin e nxënësve në një kontekst më të gjerë dhe vlerësim të aspekteve tjera si kreativiteti;**
- **Promovon përfshirje aktive të nxënësve në krijimin e dosjeve, vlerësim dhe reflektim të të nxënësit të tyre;**
- **Promovon vetë-vlerësim, reflektim dhe mendim kritik;**
- **Demonstroi përparimin, përpjekjen dhe të arriturat e nxënësve;**
- **Siguron dëshmi për diskutim për nxënësit dhe mësimdhënësit; dhe**
- **U mundëson nxënësve dhe mësimdhënësit ta vlerësojnë përparimin dhe të arriturat ndaj qëllimeve të përcaktuara.**



## Si duket një dosje e nxënësit?

Mësimdhënësja Linda Bllaca nga shkolla fillore në Gjilan mësoi për përdorimin e dosjes së nxënësve si një teknikë me të cilën mund ta vlerësojë të nxënësit e nxënësve. Ajo mendoi se mund të funksionojë me nxënësit e saj të klasës së gjashtë. Kur Linda ua shpjegoi kurrikulën për lëndën e edukatës qytetare nxënësve të vet, ajo gjithashtu i këshilloi se do të provojnë diçka të re – të mbajnë nga një dosje për punën e vet. Pasi që dëgjuan çka është dosja e nxënësit, dobitë e krijimit të saj dhe si ta përgatisin, nxënësit mezi prisnin ta provojnë këtë qasje të re të të nxënësit. Atyre u pëlqeu sidomos ideja që për disa njësi do të duhet t'i përcaktojnë kriteret e suksesit. Kur Linda u shpjegoi se nuk do të jetë vetëm përmbajtja e të nxënësit që do të vlerësohet por edhe shkathtësitë si hulumtimi dhe kreativiteti, nxënësit u motivuan edhe më shumë për ta provuar këtë metodë të re. Linda i udhëzoi nxënësit e saj se do t'i kontrollojë dosjet rregullisht dhe do t'i ofrojë informatë kthyesë secilit nxënës për përparimin e tyre dhe ide për përmirësim. Ajo gjithashtu u siguroi kohë nxënësve që në çifte ta rishikojnë dosjen e njëri-tjetrit dhe të ofrojë informatë kthyesë të bazuar në listën kontrolluese.



## Si ta bëj dosjen e vlerësimit të suksesshme?

### Planifikoje mirë

Pyetjet në vijim janë pikë fillestare kur planifikohet vlerësimi me dosje:

- Cilën njohuri do ta vlerësoj?
- Si do të kontribuojë dosja për zhvillimin dhe të arriturat e nxënësit?
- Cilat janë kriteret për zgjedhjen e përmbajtjes së dosjes?
- Cilën periudhë kohore do ta mbulojë - një gjysmëvjetor, një muaj, një vit?
- Cilat kritere do t'i përdor për ta vlerësuar punën e nxënësve?

## Organizojë në tre faza

### 1. Organizimi dhe planifikimi

Shpjegoju nxënësve qëllimin e dosjes (monitorimi dhe evaluimi i përparimit në të nxënë). Diskuto pyetjet në vijim:

- Si ta planifikoj kohën time, materialet, punën, në mënyrë që të reflektoj/analizoj atë që kam mësuar?
- Si t'i organizoj materialet dhe punën që kam mbledhur?
- Si ta plotësoj dosjen time kohë pas kohe?

### 2. Mbledhja e materialeve dhe punës

Kjo fazë e procesit përfshin mbledhjen e materialeve dhe punës të cilat reflektojnë qëllimet arsimore dhe përvojën e nxënësve. Zgjedhja e punës është bërë në:

- a) fushën lëndore      b) procesin e të nxënësit      c) llojin e produktin

### 3. Reflektimi

Faza e tretë i referohet sigurimit të kohës dhe mundësisë për reflektim nga ana e nxënësve. Reflektimet përfshijnë forma të ndryshme të raportimit me gojë dhe me shkrim.

## 2.10 Të nxënit e bazuar në probleme

### Çka është të nxënit e bazuar në probleme?

Është një metodë e të nxënit kur nxënësit mësojnë përmes zgjidhjes së problemeve dhe reflektimit në përvojat personale të të nxënit. Të nxënit e bazuar në probleme e fuqizon njohurinë e lëndës, fuqizon zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, zgjidhjes së situatave problemore dhe shkathtësive për të nxënë të vet-udhëhequr. Të nxënit e bazuar në probleme mund të jetë pjesë e një njësie të vetme apo pjesë e një projekti më të madh.

Karakteristikat tipike të të nxënit e bazuar në probleme janë:

<p><b>Mendimi kritik</b></p> <p><b>Aktivitetet në grup</b></p> <p><b>Detyrat autentike</b></p> <p><b>Fasilitimi i mësimdhënësve</b></p>	<p><i>Nxënësit analizojnë një problem dhe mundohen të gjejnë një zgjidhje, duke zgjedhur dhe përdorur strategji të përshtatshme.</i></p> <p><i>Nxënësit punojnë në ekipe të vogla.</i></p> <p><i>Nxënësit i adresojnë problemet e jetës reale.</i></p> <p><i>Mësimdhënësi i përkrah nxënësit, siguron burime dhe i drejton ata drejt definimit, zbatimit dhe evaluimit të punës së tyre.</i></p>
---	--

Për më shumë informata konsultohet 'Arkën e Thesarit' online. 


### Pse të përdoret të nxënit e bazuar në probleme? Cilat janë dobitë?

**Motivimi** - Problemet e jetës reale nxisin kërkuesin dhe nxënësit bëhen më të motivuar për zgjidhjen e tyre.

**Mendimi kritik dhe kreativ** - Probleme me fund të hapur me më shumë se një zgjidhje të nxitur nga të menduarit kritik dhe kreativ.

**Të nxënit se si të mësojmë** - Të nxënit e bazuar në probleme kërkojnë nga nxënësit të zhvillojnë strategji të tyre për definimin e problemeve, mbledhjen e informatave, analizën e të dhënave, vendim-marrjen dhe zgjidhjen e problemeve.

**Puna ekipore** - Të nxënit e bazuar në probleme përfshin punën në ekip dhe fuqizon shkathtësitë e komunikimit dhe ato ndërpersonale.



### Çka ndryshon nga të nxënit tradicional?

Të nxënit tradicional	Të nxënit e bazuar në probleme
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësi i transferon informatat - ligjëron</li> <li>Nxënësi kryesisht mbajnë mend</li> <li>Mësimdhënësi u jep një problem për ta praktikuar dhe zbatuar teorinë e mësuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit dhe mësimdhënësit zgjedhin një problem</li> <li>Nxënësit identifikojnë atë që duhet të dinë dhe e hulumtojnë</li> <li>Nxënësit mësojnë dhe zbatojnë njohuritë e reja në mënyrë që ta zgjidhin problemin</li> </ul>

## Si duket të nxëniet e bazuar në probleme?

Pasi që lexoi për tsunamin, pothuaj se shkrijen e centralit nuklear në Japoni, dhe pasojat potenciale serioze për punëtorët e plant, Hajriz Rashiti, mësuesi i teknologjisë në shkollën fillore Vëllezërit Frashëri në Lipjan i sfidoi nxënësit e tij me një problem duke përdorur një robot.



**Ai u shpjegoi situatën potenciale duke i informuar nxënësit se një nga reaktorët nuklearë është prishur dhe pesë nga dhjetë shufrat e putonit janë tejnxehur. Hajrizi i pyeti pastaj: “A mund të ndërtoni dhe ta programoni një robot të hyjë në central dhe të përcaktojë cilat shufra janë tejnxehur?”**

Hajrizi dhe nxënësit diskutuan së bashku se çka do tu nevojitej për ta zgjidhur problemin. Pastaj, nxënësit në grupe:

- Bën një plan të dhomës në central;
- Mbledhën materialet e nevojshme, duke përfshirë ato të reciklueshme;
- Përgatitën modele të dhomës dhe i pozicionuan shufrat, ato që punojnë mirë dhe ato që janë tejnxehur;
- Ndërtuan një robot duke përfshirë mekanizmin për alarm kur vërehet një shufër e tejnxehur; dhe
- Programuan një algoritëm për lëvizjen e robotit;

Programimi i robotit kërkoi shumë prova dhe reprogramim por nxënësit ishin të motivuar nga shembulli i jetës reale të ofruar nga mësuesi i tyre.

## Si ta bëj të nxëniet e bazuar në probleme të suksesshëm?

### 1. Provo të ofrosh një problem autentik (për më shumë informata shih ‘Arkën e Thesarit’ online)

- Mendo për një skenar nga jeta reale. Mund të merrni ide për krijimin e problemeve reale të lidhura me kurrikulën, nga ngjarje të jetës së përditshme përmes leximit të gazetave, revistave të ndryshme, etj.
- Adapto detyrën në bazë të njohurive të mëparshme të nxënësve tuaj dhe nivelit të tyre të pavarësisë gjatë punës.
- Përgatite detyrën në formë të shkruar në mënyrë që të jetë mjaft konkrete dhe e definuar saktë ashtu që nxënësit t’i kuptojnë detajet e rëndësishme.

### 2. Prezanto problemin me kujdes para nxënësve

- Qartëso situatën problemore ashtu që të jesh e sigurtë se të gjithë nxënësit e kuptojnë.
- Diskuto procesin dhe hapat e të nxëniet në bazë të problemeve.
- Përdor **teknika të stuhisë së mendimeve** për t’i përfshirë të gjithë nxënësit.
- Pajtohuni për rolet dhe përgjegjësitë e nxënësve dhe të mësuesit;

### 3. Vendos si do t’i vlerësosh nxënësit para se të fillosh

Të nxëniet e bazuar në probleme mund të vlerësohet në mënyra të ndryshme si:

- Vëzhgimi i diskutimeve të nxënësve dhe diskutimeve të mësuesit me nxënësit;
- Prezantimet me gojë, detyrat me shkrim; dhe
- Vetë-vlerësimi i nxënësve dhe vlerësimi i bashkëmoshatarëve.

## 2.11 Të nxënit e bazuar në projekte

### Çka është të nxënit e bazuar në projekte?

Është metodë në të cilën nxënësit punojnë së bashku për të hulumtuar çështje dhe probleme të jetës reale, duke përdorë strategji të zgjidhjes së problemeve dhe burime të ndryshme në mënyrë që të prodhojnë një produkt final.

Karakteristikat tipike të të nxënit e bazuar në projekte janë:

<b>Produktet finale</b>	<i>Nxënësit punojnë për të krijuar një produkt. Ai mund të jetë: një objekt, një lojë, një video film, një prezantim, etj.</i>
<b>Aktivitetet grupore</b>	<i>Nxënësit punojnë në ekipe.</i>
<b>Detyrat shtesë</b>	<i>Projektet mund të vazhdojnë për një periudhë kohore dhe të përfshijë më shumë se një njësi mësimore.</i>
<b>Detyrat autentike</b>	<i>Projektet mundohen të zgjidhin probleme të jetës reale.</i>
<b>Qasja ndër-kurrikulare</b>	<i>Projekti mund të përfshijë më shumë se një lëndë dhe mund të nevojitet që mësimdhënësit të punojnë së bashku.</i>
<b>Mendimi kreativ</b>	<i>Kërkohet që nxënësit t'i zhvillojnë zgjidhjet e tyre.</i>
<b>Mendimi kritik</b>	<i>Duke punuar së bashku ata duhet t'i analizojnë problemet dhe t'i marrin parasysh mundësitë.</i>
<b>Hulumtimi i pavarur</b>	<i>Nxënësit përdorin llojllojshmëri burimesh për të gjetë informata, shpesh duke përfshirë TIK-un.</i>
<b>Fasilitimi i mësimdhënësit</b>	<i>Mësimdhënësi përkrah nxënësit, siguron burime dhe i udhëzon drejt definimit, zbatimit dhe evaluimit të detyrës së hulumtuar.</i>

### Pse të përdoret të nxënit e bazuar në projekte? Cilat janë dobitë?

- Të nxënit e bazuar në projekte është më përmbajtësor dhe motivues për nxënësit dhe mundëson arritjen e niveleve më të larta të zhvillimit njohës;
- U mëson nxënësve shkathtësitë relevante si edhe përmbajtjen; dhe
- Këto shkathtësi janë shkathtësi për tërë jetën si puna ekipore dhe shkathtësitë udhëheqëse, shkathtësitë e komunikimit dhe prezantimit, shkathtësitë e organizimit dhe menaxhimit të kohës, shkathtësitë e hulumtimit dhe kërkimit, shkathtësitë e vetë-vlerësimit dhe reflektimit.

### Çka ndryshon nga të nxënit tradicional?

Udhëzimet tradicionale	Të nxënit e bazuar në projekte
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcjellja e udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi</li> <li>• Mbajtja mend dhe përsëritja e fakteve</li> <li>• Dëgjimi dhe reagimi ndaj pyetjeve të parashtruara</li> <li>• Marrja e njohurive – fakteve, termave dhe përmbajtjes</li> <li>• Të nxënit e teorisë</li> <li>• Vartësia në mësimdhënësin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizimi i aktiviteteve të vetë-drejtuar të të nxënit</li> <li>• Hulumtimi, integrimi dhe prezantimi i informatave</li> <li>• Komunikimi dhe marrja e përgjegjësisë për të nxënë</li> <li>• Kuptimi i procesit të të nxënit me anë të zgjidhjes së problemeve dhe hulumtimit</li> <li>• Aplikimi i teorisë</li> <li>• Mbështetja dhe rirforcimi nga mësimdhënësi.</li> </ul>

## Si duket të nxëniet e bazuar në projekte?

Nxënësit e shkollës fillore Zekeria Rexha në Gjakovë filluan të shqetësohen gjithnjë e më shumë për dhunën në shkollë. Ata vendosën ta ngritin vetëdijen për këtë problem në rritje në shkollat e Kosovës. Në fillim ata i përfshinë shokët e klasës në një diskutim për llojet e dhunës që ndodhnin dhe cilat mund të jenë disa nga arsyet e mundshme. Ata hulumtuan në internet për temën e dhunës në shkollë, hulumtuan artikuj në gazeta për dhunën dhe të rinjtë. Pastaj vendosën se mënyra më e mirë për ta shpërndarë porosinë për rritjen e dhunës dhe ndikimin e dëmshëm që ka



është përmes një video. Nxënësit i paraqitën pikat kryesore dhe pastaj e shkruan videotregimin e pasuar nga skenari. Pastaj ata bënë prova për role të ndryshme dhe praktika në skenë. Duke përdorur flip kamerën, ata filmuan e filmuan në mënyrë që të kenë mjaft xhirime për ta edituar një film prej dhjetë minutash dhe për të hyrë në garën e Junior Oscar. Ata ishin jashtëzakonisht të lumtur që filmi i tyre fitoi në njërin nga kategoritë.

Përveç zhvillimit të shkathtësive të hulumtimit, shkrimit dhe TIK-ut, projekti e ngriti njohurinë e nxënësve për problemet globale të dhunës dhe masave që po ndërmerren për tu marrë me to. Ata gjithashtu kuptuan se mund të jenë pjesë e zgjidhjes duke ndërmarrë veprime për çështje shoqërore e që janë reale për të gjithë të rinjtë.

## Si ta bëj të nxëniet e bazuar në projekte të suksesshëm?

Për më shumë informata konsultoj 'Arkën e Thesarit' online. ➡

### 1. Planifiko mirë

- Përcakto shkathtësitë dhe konceptet që do të zhvillohen nga nxënësit dhe formuloni rezultate të qarta të të nxëniet në lidhje me sillabusin.
- Së bashku me nxënësit, përgatit një plan të detajuar për mbajtjen e aktiviteteve (duke i definuar detyrat në të cilat do të punojnë nxënësit, formimin e grupeve, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësisive të anëtarët e grupeve).
- Së bashku me nxënësit, hartoni udhëzime dhe rregula të punës në projekt.
- Merr parasysh bashkëpunimin me kolegë për të zhvilluar një projekt ndër-disiplinar.
- Integro teknologjinë kur është e mundshme.
- Përgatit burimet e nevojshme duke siguruar qasje të lehtë për përdorim të tyre.
- Përkujtoi nxënësit për rolin dhe përgjegjësinë e secilit anëtar të grupit.

### 2. Vendos se si do t'i vlerësosh nxënësit para se të fillosh

Së bashku me nxënësit, planifiko vlerësimin paraprakisht. Vlerësimi i projekteve përfshin:

- Vlerësimin e procesit të punës dhe produktin/raportin e projektit.
- Vlerësimi nga mësimdhënësi, vlerësimi nga bashkëmohatarët dhe vetë-vlerësimi.

## 2.12 Hulumtimi i pavarur

### Çka është hulumtimi i pavarur?


Aspekt thelbësor në të nxënit përmes projekteve është hulumtimi i pavarur ku nxënësit (individualisht apo në grupe) përdorin burime, kryesisht të pandihmuar nga mësuesi, për të gjetë informata. Ky hulumtim mund të kontribuojë për ndonjë projekt më të madh, duke përfshirë një grup më të madh apo tërë klasën. Nxënësit mund ta kombinojnë të nxënit nga hulumtimi i vet për ta informuar një problem apo çështje më të gjerë si edhe për të siguruar ide që do të çojnë drejt një produkti më të mirë grupor.

Rezultatet e hulumtimit mund të jenë fund më vete.

### Hapat në procesin e hulumtimit

Për më shumë informata konsultohet 'Arkën e Thesarit' online.

Në vijim është përshkrimi i një hulumtuesi për procesin e hulumtimit. Ju mund të gjeni të tjera po principet themelore janë të njëjta:



### Pse të inkurajohet hulumtimi i pavarur? Cilat janë dobritë?

- 1. Motivimi** - Problemet e jetës reale e shtojnë kërshërinë dhe nxënësit bëhen më të motivuar për t'i zgjidhur ato (Lexo më shumë në 'Arkën e Thesarit' online).
- 2. Mund të çojë drejt të menduarit e nivelit më të lartë** - problemet e mira hulumtuese mund të ndihmojnë në zhvillimin e shkathhtësive të nivelit të lartë të mendimit (shih "Taksonominë e Blumit").
- 3. Të nxënit si të mësojmë** - hulumtimi i pavarur kërkon nga nxënësit t'i zhvillojnë strategjitë e veta për definimin e problemeve, mbledhjen e informatave, analizën e të dhënave, vendim-marrjen dhe zgjidhjen e problemeve.

**Kështu që - nxënësit janë të përgatitur "të nxënë si të mësojnë" dhe t'i fitojnë shkathhtësitë që janë thelbësore për të nxënit gjatë gjithë jetës.**

Angazhimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të reja mundëson arritjen e niveleve të larta të zhvillimit njohës.

- Nxënësit punojnë në një problem të hapur i cili ofron llojllojshmëri zgjidhjesh;
- Ata marrin pjesë në dizajnimin e procesit të të nxënit si të arrihet deri te zgjidhja;

- Ata inkurajohen të mendojnë në mënyrë kritike dhe marrin përvoja praktike në zgjidhjen e problemeve, komunikimin dhe vetë-organizimin;
- Ata marrin vendime gjatë procesit të të nxënës;
- Ata reflektojnë mbi aktivitetet e zbatuara dhe vlerësimi ndodh në mënyrë të vazhdueshme;
- Ata zhvillojnë shkathtësi për punë ekipore
- Ata mund të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të cilat do të jenë të domosdoshme për karrierën e tyre të suksesshme në jetë.

### Siduket një projekt hulumtues?

Ndonjëherë thuhet se vajzat nuk janë të interesuara në teknologji dhe se për këtë shkak ka shumë më shumë meshkuj në karriera që kanë të bëjnë me teknologji. Megjithatë, atëherë shumë profesione apo vende pune sot kanë ndonjë aspekt të teknologjisë të inkorporuar në punë. Vajzat në klasën e tetë dhe nëntë në disa shkolla të Kosovës patën mundësi të eksperimentojnë me teknologji dhe të hulumtojnë karriera në teknologji. Disa vajza kanë hulumtuar edhe aspektet e teknologjisë që janë të përfshira në profesionet që u interesojnë, p.sh. arkitekturë, biologji, kostumografi, medicinë, inxhieri. Duke përdorur një format të adaptuar të procesit të hulumtimit më lart, vajzat e shkollës fillore Gjon Serreçi në Ferizaj e bënë një hulumtim për karrierat e reja në teknologji përderisa vajzat tjera u fokusuan në karrierat tashmë të zgjedhura. Vajzat raportuan për gjetjet e tyre para bashkëmoshatarëve.



### Si e bëj një projekt hulumtues të suksesshëm?

#### Bëni nxënësit kureshtar

Prezantoni hulumtimin në mënyrë interesante. Thjesht mundohuni t'u tregoni një tregim të mirë dhe të filloni të bëni pyetje. Nëse nuk jeni tregues i mirë, tregojni ndonjë film apo fotografi, sjell ndonjë objekt, vizito ndonjë muze, prezanto uebfaqe, lexo një poezi apo skenë tërheqëse nga një libër, fto ndonjë mysafir – lista e mundësive është e pafund dhe varet nga nxënësit dhe tema juaj.

#### Bëji të jenë të interesuar

Inkurajoni nxënësit tuaj ta zgjedhin temën për të cilën kanë interesim personal. Temë me disa elemente kontraverse do të jetë më interesante për hulumtim. Një pyetje me një përgjigje të veçantë do të funksionojë më së miri. Në vend të prezantimeve që kanë të bëjnë me faktet, kërkoni nga nxënësit ta identifikojnë një zgjidhje, një hap konkret që mund ta ndërmarrin, apo një rekomandim për këshillin e nxënësve apo kryetarit të komunës.

#### Mbaji të sinqertë

Ndërtimi i kujdesshëm i detyrës tuaj është mbrojtja juaj e parë ndaj plagjitarizimit të nxënësve. Ofroju nxënësve mundësi për ta shikuar temën nga një perspektivë personale. Hulumtimi i cili kërkon vetëm ritheksimin e fakteve është i mërziqshëm dhe bëhet ftesë për ta kopjuar punën e autorit. Nëse u kërkohet nxënësve ta fillojnë projektin e tyre me një pyetje personale dhe të veçantë dhe kontrollimi i tyre në secilin hap është mënyra më e mirë e parandalimit të plagjitarizimit.

#### Tregojni fundin

Ndaj pak kohë në fillim të projektit për ta shpjeguar procesin e vlerësimit. Kërko ide nga nxënësit. Ndajni kriteret e suksesit me nxënësit.

## 2.13 Projektet në veprim

### Çka është projekti në veprim?

Është metodë në të cilën nxënësit punojnë duke bashkëpunuar për të hulumtuar çështje komplekse të jetës reale duke përdorë strategji të zgjidhjes së problemeve dhe burime të ndryshme. Hulumtimi çon drejt veprimit në shkollë apo komunitet për përmirësimin e jetës.

Projektet mund të përfshijnë projekte të qytetarisë, projekte të mjedisit, të lidhura me shëndet apo me fokus në diskriminimin gjinor. Ato zakonisht do të vazhdojnë për një periudhë kohore. Ai përfshin të nxënit autentik (shih 'Arkën e Thesarit' online) por aspekti thelbësor është **ndërrmarja e veprimit në mënyrë që të krijohet ndryshim dhe përmirësim.**

Projektet në veprim mund të:

- jenë ndër-kurrikulare dhe të përfshijnë mësimdhënës të lëndëve të ndryshme që planifikojnë së bashku
- përfshin përdorimin e TIK-ut për hulumtim apo shpërndarjen e informatave; dhe
- përfshirn anëtarët e komunitetit të gjerë.

### Pse të përdoret një projekt në veprim? Cilat janë dobitë?

Pjesëmarrja e nxënësve në projekte në veprim ngrit shkathtësitë dhe qëndrimet në vijim të nxënësit:

- ndryshim të qasjeve ndaj shkollës dhe mjedisit më të gjerë;
- ngritja e shkathtësive të punës ekipore dhe komunikimit; gjithashtu shkathtësitë e të menduarit: mendimi kreativ, vendim-marrja, zgjidhja e problemeve, të dimë si të mësojmë;
- Shkathtësitë për zgjedhje, organizim, planifikim dhe sigurim të burimeve;
- Shkathtësitë për përdorim të teknologjisë;
- Cilësitë personale: përgjegjësi, vetë-besim, vetë-respekt, vetë-organizim; dhe
- Mund të japë ndjenjën e fuqizimit përmes ndërmarrjes së veprimit.



### Si duket projekti në veprim?

Shkolla fillore "SHMU 2", në Vushtrri gjendet afër stacionit të policisë dhe spitalit gjë që u lejon hapësirë të vogël për oborr të shkollës dhe pothuaj pa hapësirë brenda apo përreth shkollës. Klubi i Gjelbër i formuar së voni e i udhëhequr nga mësimdhënësi Niman Bajraktari, vendosi të bëjë diçka në lidhje me këtë. Ata mblodhën informata për mundësitë që i kanë për ta ndryshuar situatën dhe pastaj dhanë ide për veprime specifike të cilat janë të mundura.


1. Veprimi # 1: Veprimi i parë që u ndërmorr solli pak gjelbërsi në shkollë pasi që nuk pat mundësi për rritjen e hapësirës së gjelbër në ambientin e jashtëm. Ata mblodhën dhe mbollën 36 saksia lulesh në të dy katet e shkollës duke e bërë atë më mirëseardhëse dhe një mjedis më të shëndetshëm.
2. Veprimi # 2: Përmes një kampanje vetëdijësuese, nxënësit e ngritën vetëdijen në shkollë dhe në komunitet për mjedis të pastër dhe të ndotur dhe efektet negative të kësaj të fundit në shëndet. Ata udhëhoqën një aktivitet pastrimi për Ditën e Tokës të shënuar në tërë botën çdo 22 prill.
3. Veprimi #3: Pastaj nxënësit e shfrytëzuan një mundësi për ta pranuar shtypësin e shisheve të plastikës dhe një kafaz të metaltë në të cilin të gjithë anëtarët e shkollës, por edhe komuniteti përreth mund t'i depozitonte shisheet. Atëherë shkolla nënshkroi kontratë me një kompani reciklimi nga cila do të fitonte fonde që do të përdoren nga shkolla.

Shkollat e gjelbëra besojnë se nxënësit duhe të jenë vetë agentë të ndryshimit të sjelljes së komunitetit në lidhje me kujdesin ndaj mjedisit dhe praktikimit të qytetarisë aktive.



## Si ta bëj projektin në veprim të suksesshëm?

Përdor qasjen prej katër fazash:



### Hulumto

Nxënësit, të udhëhequr nga mësimmshënësi:

- Së bashku zgjedh një problem të cilin do të dëshirojnë ta hulumtojnë;
- Jep arsye pse kjo temë është e rëndësishme për ta;
- Bëj analizën e situatës momentale në lidhje me temën;
- Merr ide për mundësitë për zgjidhjen e problemeve;
- Krijohet një plan hulumtimi me aktivitete të përcaktuara në mënyrë specifike;
- Përdor mjete të ndryshme për mbledhjen e informatave (analiza e materialeve, intervista me anëtarë të komunitetit, hulumtim në internet, debate publike); dhe
- Procesohet të dhënat e mbledhura – shkruaj një raport; tregoj rezultatet në mënyrë grafike dhe nxjerr përfundime.

### Imagjino zgjidhjen

Nxënësve u jepet mundësia ta imagjinojnë se si mund të përmirësohet situata në disa mënyra:

- Fjalët: Përshkrimi i situatës ideale dhe si do ta arrish atë; dhe
- Nxënësit mund t'i prezantojnë vizionet e tyre përmes formave të ndryshme si vizatimi, ngjyrosja, modelimi, këndimi, dramatizimi, etj.

### Planifikimi dhe ndërmarrja e veprimit

Të gjithë nxënësit punojnë së bashku apo në grupe për tu pajtuar për planin e veprimit për realizimin e vizionit të tyre:

- Plani i veprimit parasheh hapat që duhen marrë për të sjellë ndryshim; dhe
- Plani i veprimit duhet të përmbajë veprime specifike, persona përgjegjës, afat kohor, etj. (plani i veprimit i përgjigjet pyetjeve *çka, kush dhe kur*).

### Bëj një ndryshim pozitiv

Zbatimi i suksesshëm i planit të veprimit rezulton në ndryshime dhe nxënësit i zgjidhin problemet të cilat i identifikojnë në fillim të hulumtimit:

- Nxënësit i vlerësojnë rezultatet dhe cilësinë e ndryshimit të bërë nga veprimi i zbatuar; dhe
- Nëse veprimi nuk është i suksesshëm, nxënësi mund të fillojë të hulumtojë sërish pse ka ndodhë ashtu dhe pastaj të ndërmer veprim.

## JU LUTEM, MOS E HARRONI VLERËSIMIN!

Në një projekt në veprim, efektet dhe ndryshimet e bëra janë elementet e vlerësuara më së shpeshti. Efikasiteti në zbatimin e ndryshimeve testohet përmes kriterëve dhe indikatorëve të suksesit të hartuar nga nxënësit (shembull i indikatorëve për shembullin më lart mund të jetë: 'Numri i nxënësve që marrin pjesë në ditën e pastrimit' apo 'Perceptimi i nxënësve për rëndësinë e moshedhjes së mbeturinave').

## 2.14 Projektet e sfidës së dizajnit

### Çka është projekti i sfidës së dizajnit?

Projekti i sfidës së dizajnit është ai ku nxënësit angazhohen në procese të dizajnit për të zgjidhur probleme përkatëse, autentike, të botës reale. Ekipet e nxënësve i zbatojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre të përmbajtjes në Teknologji, Shkencë si edhe në Matematikë, Shkenca Shoqërore dhe Gjuhë, përmes një procesi të hapur që rezulton në një zgjidhje origjinale. Ekzistojnë tri pjesë të procesit të dizajnit:

#### Koncepto


- Identifiko problemin, materialet & pengesat
- Mendo ide dhe zgjidhje të ndryshme

#### Ndërto & Testo

- Zgjedh një zgjidhje
- Dizajno dhe Ndërto
- Testo Prototipin
- Ridizajno apo modifiko
- Ritesto

#### Merr Njohuri

- Hulumto
- Ndaji zgjidhjet
- Reflekto dhe diskuto



Diagrami më lart përfaqëson procesin e inxhinierimit dhe/apo dizajnit. Ekipet nuk e përcjellin një rrugë lineare nga problemi deri në zgjidhje, por më parë lëvizin nga njëra në tjetrën nëpër konceptim, ndërtim dhe testim dhe marrje të njohurive, përdërisa i zbatojnë shkathtësitë e ndryshme dhe veprojnë sipas mendësisë së zbuluesit.

### Pse të përdoret qasja e sfidës së dizajnit? Cilat janë dobitë?

- Përmes procesit të Sfidës së Dizajnit, nxënësit kanë mundësi të ndërtojnë shkathtësi më të gjera (p.sh. puna ekipore, kreativiteti, mendimi kritik) të dobishme gjatë tërë jetës, pa marrë parasysh veçantitë e sfidës.
- Gjatë përdorimit të qasjes së hapur që çon drejt krijimit të shumë dizajneve, nxënësit sfidohen t'i zbatojnë njohuritë e tyre, përvojat personale, ineresimet dhe talentet në procesin e krijimit të një zgjidhje inovative të drejtuar nga ekipi.
- Kjo qasje krijon përvojë të fuqishme të të nxënësve kur nxënësit janë të inspiruar nga brenda për të mësuar dhe ndjejnë krenari në arritjen e qëllimeve si ekip.

### Çka ndryshon nga të nxënësve tradicional?

Të nxënësve tradicional të teknologjisë	Të nxënësve përmes sfidës së dizajnit
Nxënësve u mësohen vetëm shkathtësitë e punëdores	Nxënësve u mësohen edhe shkathtësitë e dizajnit
Nxënësit punojnë në mënyrë individuale	Nxënësit punojnë në ekipe
Të gjithë nxënësit e krijojnë të njëjtin produkt	Nxënësit e dizajnojnë produktin e vet
Theksohet cilësia e produktit përfundimtar	Theksohet cilësia e të menduarit dhe kreativitetit

## Si duket projekti i sfidës së dizajnit?

**Ndihmoi Fermerit të Pulave** - Nxënësit e shkollës fillore Naim Frasheri në Prishtinë punuan në një sfidë të dizajnit që iu dha atyre nga një fermer i pulave.<sup>6</sup>

**Kur pulat e mia bëjnë ve në folenë e tyre, ato rrotullohen në një pjerrëtitë deri në vendin përfundi kutisë. Pasi që përfundi folesë është ngrohët, ato prishen nëse qëndrojnë aty për një kohë më të gjatë.**

**Mua më nevojitet një makinë e cila do ta:**

1. lëvizë vezën për një metër nga kutia në një vend të ftohtë; dhe
2. më lajmëron kur veza ka arritur në vendin e ftohtë.



**Unë sapo e kam blerë një kompjuter. A mund ta dizajnoni një makinë dhe një program kompjuterik i cili do të më ndihmojë?**

Nxënësve u janë dhënë disa kriterë: makina duhet të:

- lëvizë së paku një ve të vërtetë;
- lajmëroj kur veza transferohet;
- kthehet në pozitën fillestare e gatshme për ta transferuar një vezë tjetër;
- të mos jetë e shtrenjtë (duke përdorë materiale të thjeshta duke përfshirë atë të reciklueshme);
- demonstroj përdorimin e kutisë kontrolluese të kompjuterit; dhe
- përdorë së paku një mjet sensorik, një motor dhe një dritë.

Problemi u prezantua si sfidë e dizajnit për nxënësit e teknologjisë në pothuaj se njëzet shkolla. Nga ta u kërkua ta shkruajnë idenë e dizajnit. Ata diskutuan në grupe zgjidhje të ndryshme dhe i vizatuan planet. Këto ide u prezantuan para gjithë grupit. Pastaj grupet i krijuan, testuan dhe vlerësuan prototipe të ndryshme. Pasi që i morrën parasysh këto, klasa vendosi për zgjidhjen më të mirë dhe e prodhuan produktin përfundimtar.

## Si ta bëj projektin e sfidës së dizajnit të suksesshëm?

### Planifiko mirë

- Përcakto një sfidë të përshtatshme: të tillë që të jetë në kuadër të aftësive teknologjike të nxënësve.
- Planifiko orën mirë ashtu që nxënësit të mund të punojnë të sigurtë në grupe dhe të kenë qasje në materiale dhe mjete.
- Mbani mjetet dhe materialet që mund të ju nevojiten në dispozicion. (Nxënësit mund të jenë në gjendje të sjellin materiale harxhuese dhe të lira nga shtëpia.)
- Ofroni zgjedhje të mjeteve dhe materialeve për të lejuar mundësi të ndryshme.

### Organizoj mirë

- Organizoi nxënësit në grupe të vogla ashtu që të gjithë nxënësit të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në ndonjë mënyrë. Sigurohu ta inkurajosh përfshirjen e plotë të vajzave dhe djemve. Monitoroje këtë
- Prezantoje sfidën para tërë klasës. Kohë pas kohe organizo stuhi mendimesh për t'i diskutuar problemet dhe për t'i identifikuar zgjidhjet.
- Siguro mundësi për hulumtim dhe mbledhje të ideve: përmes internetit; në libra dhe revista; apo në mjedis.
- Përdor diferencimin – disa grupe mund ta përdorin internetin për hulumtim përderisa të tjerët punojnë me materiale dhe të tjerët i shkruajnë raportet dhe prezantimet e tyre.

### Vlerësoje mirë

- Nxënësit duhet të marrin përgjegjësi për vlerësimin e përparimit të tyre dhe ta përfshijnë informatën kthyesë nga moshatarët përderisa i hartojnë dhe ridizajnojnë projektet e tyre. Siguroju nxënësve apo zhvilloje me ta një mjet vlerësimi të bazuar në kriterë të sfidës dhe proceseve të përdorura nga nxënësit.

## 2.15 Të nxënit ndërmarrës

### Çka është të nxënit ndërmarrës?

Të nxënit ndërmarrës është një lloj i të nxënit autentik në të cilin nxënësit zhvillojnë shkathtësi dhe qëndrime ndërmarrëse duke punuar në mënyrë kreative dhe aktive në projekte praktike.

Të nxënit ndërmarrës përfshin 'mësimin nga praktika'. Themelimi dhe mbajtja e biznesit apo ndërmarrjes (sado të vogël) është diçka nga e cila mund të përfitojnë të gjithë. Është mundësia që u jepet të rinjve për ta përjetuar biznesin e vërtetë dhe të nxënit në lidhje me punën përmes aktiviteteve të kompanive ndërmarrëse.



### Pse të përdoret të nxënit ndërmarrës?

#### Cilat janë dobitë?

Inkurajimi i sensit ndërmarrës dhe fuqizimi i tij me shkathtësi relevante është thelbësor për zvogëlimin e papunësisë, krijimin e vendeve të punës, motivimin e nisjes së bizneseve, sigurimin e mundësive për vetë-përmbushje, përmirësimin e konkurrencës dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

Aktivitetet e të nxënit ndërmarrës sigurojnë sfida dhe mundësi të reja për ta demonstruar kreativitetin. Ato gjithashtu u mundësojnë të gjithë fëmijëve dhe të rinjve ta zhvillojnë një gamë të shkathtësive përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë. Ata mësojnë se të qenit udhëheqës nuk nënkupton vetëm tu tregosh të tjerëve çka duhet të bëjnë. Ata mësojnë për vlerën e punës ekipore, rëndësinë e strategjive të komunikimit të mirë, si ta prezantojnë informatën me shkrim, me gojë dhe përmes prezantimeve vizuale, si të ballafaqohen me dështime dhe me mësimet pozitive të cilat mund t'i marrin nga përvoja.

Këto shkathtësi janë të vlefshme për punëtorët, punëdhënësit dhe ndërmarrësit e ardhshëm, dhe ndërlidhen me të gjitha lëndët përgjatë kurrikulës.

### Çka ndryshon nga të nxënit tradicional?

Mësimdhënia tradicionale	Të nxënit ndërmarrës
<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësve u sigurohen burimet nga mësimdhënësi</li> <li>Ndihma e mësimdhënësit është e dhënë</li> <li>Nxënësit punojnë në mënyrë individuale</li> <li>Shpesh herë imagjinata dhe kreativiteti i nxënësve nuk sfidohet</li> <li>Problemet janë me bazë në shkollë</li> <li>Produktet e nxënësve gjykohen nga mësimdhënësi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit duhet t'i identifikojnë burimet e veta dhe të 'paguajnë' për to</li> <li>Nxënësit duhet ta paguajnë mësimdhënësin për ndihmë</li> <li>Nxënësit punojnë në çifte apo grupe</li> <li>Imagjinata dhe kreativiteti janë shkathtësitë që përfshihen</li> <li>Problemet janë të bazuara në situata reale</li> <li>Produktet e nxënësve gjykohen nga klienti</li> </ul>

## Si duket edukimi ndërmarrës?

Nxënësit e Klubit të Gjellbër në shkollën Hilmi Rakovica në Prishtinë, të udhëqur nga mësimdhënësja Jehona Oruqi, dhanë ide për potencialin e shkollës për reciklim. Nxënësit donin të fitojnë fonde për ta ndihmuar shkollën e tyre e në të njëjtën kohë tu ndihmojnë bashkëmoshatarëve të kuptojnë se secili mund të kontribuojë në çështjet e mjedisit. Përderisa e bënë një proces joformal hulumtimi, reciklimi i letrës doli si një mundësi e dukshme. Për ta ngritur vetëdijen në mesin e moshatarëve, anëtarët e Klubit të Gjellbër krijuan forma dhe figura të ndryshme nga letra e përdorur dhe e nisën një kampanjë informimi në lidhje me mjedisin e pastër të drejtuar ndaj të gjithëve në shkollën e tyre: nxënësit, mësimdhënësit, administratorët dhe prindërit. Pastaj Klubi i Gjellbër e përfshiu edhe Këshillin e Prindërve duke kërkuar përkrahje. Pastaj u takuan me një kompani ricikluese që rezultoi me një kontratë në mes të shkollës dhe kompanisë. Në të njëjtën kohë, nxënësit hulumtuan dhe vendosën për një puzzle makinë pasi që shkolla mund ta blente tanimë atë por edhe kompania ishte e gatshme t'i siguronte shkollës letër ricikluese që nevojitej për përdorim në puzzle makinë. Tash të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit e klasave të larta mund të zhvillojnë materiale për mësimdhënie dhe të nxënës falë përpjekjeve ndërmarrëse të anëtarëve të Klubit të Gjellbër dhe mësimdhënëses së tyre.



## Si ta bëj të nxënit ndërmarrës të suksesshëm?

### Pyet veten - A i inkurajoj qëndrimet ndërmarrëse?

- I inkurajoj në mënyrë aktive nxënësit e mi për tu angazhuar në jetën e shkollës dhe komunitetit në një mënyrë pozitive për të mirë të shkollës dhe të komunitetit të gjerë?
- Gjatë mësimdhënies sime, a i angazhoj nxënësit e mi në projekte sfiduese e praktike ndërmarrëse të cilat u lejojnë të gjenerojnë ide origjinale dhe të veprojnë në bazë të tyre?
- A mundohen praktikatat e mia klasore të zhvillojnë të kuptuar të funksioneve dhe roleve kryesore të biznesit?
- A mundohen praktikatat e mia klasore t'i zhvillojnë shkëlqësitë e planifikimit, ndikimit, negociimit, vendim-marrjes, menaxhimit të rizikut dhe punës ekipore?

### Organizo - aktivitete në lidhje me biznesin

- Fto mysafirë në klasën tuaj për të biseduar për punën e tyre, p.sh. ndërmarrësit e rinj, menaxherë biznesi, specialistë, zanatlinjë, industrinë e shërbimeve, (restorante, autolarje).
- Organizo vizita për nxënësit në kompani dhe biznese vendore (të vogla dhe të mëdha).
- Bëj anketa në mesin e konsumatorëve.
- Siguro materiale në lidhje me bizneset, (p.sh. uebfaqe, gazeta, revista, literaturë reklamuese dhe promocionale, broshura, etj.).
- Organizo përvoja si zëvendësime 'në hije'.

### Themelo – një mini kompani në katër faza:

Faza 1 - *Identifiko një problem apo nevojë*: nxënësit gjenerojnë ide përmes diskutimit për të arritur deri te idea e përbashkët e asaj që është e nevojshme për ta zgjidhur problemin apo plotësuar nevojën;

Faza 2 - *Planifiko projektin apo aktivitetin*: ndaji detyrat, organizoi burimet, përcaktoj anëtarët e ekipit dhe ndaji përgjegjësitë;

Faza 3 - *Zbatoje planin*: duke zgjidhur probleme apo duke i plotësuar nevojat e tregut, duke monitoruar përparimin; dhe

Faza 4 - *Vlerësoje procesin*: duke i rishikuar aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare, duke reflektuar në mësimet e nxjerra dhe duke i vlerësuar shkëlqësitë, qëndrimet, cilësitë dhe të kuptuarit e fituar.

## 2.16 Integrimi i Barazisë Gjinore në Klasë

*“Të ulur në të njëjtën klasë, duke i lexuar të njëjtat libra, duke e dëgjuar të njëjtin mësues, djemt dhe vajzat marrin edukim shumë të ndryshëm.”<sup>7</sup>*

*“.....hulumtimi i klasës tregon se vajzat dhe djemt vazhdojnë të shoqërohen në aso mënyra që punojnë kundër.”<sup>8</sup>*

### Çka është barazia gjinore?

**Qëllimi primar** i përpjekjeve për barazi është të sigurohen mundësi të barabarta për të gjitha femrat dhe meshkujt në të gjitha sferat e jetës qoftë ekonomike, politike, shoqërore apo kulturore.



Në Kosovë, barazia gjinore është e garantuar me Kushtetutë duke u munduar të “sigurojë barazi gjinore si vlerë fundamentale për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen edhe të femrave edhe të meshkujve në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe fushat tjera të jetës shoqërore.”<sup>9</sup>

### Pse duhet të brengosem për barazi gjinore në klasën time?

Barazia gjinore nënkupton një klasë që vepron mbi principin e drejtësisë. Kështu që, mësuesit që anojnë në aspekt gjinor, në klasë praktikojnë zgjedhje dhe mundësi të kufizuara andaj edhe krijojnë klasë që janë të padrejta për gjysmën e nxënësve.

Shkollat e kështu edhe klasat janë mikokosmose të shoqërisë. Nëse në shoqëri ka praktika diskriminuese dhe shoqëri paragjykyese, me siguri se këto ekzistojnë në shumicën e klasave. Veprimet, qëndrimet dhe sjelljet konsiderohen mashkullore dhe u ipet vlerë më e madhe se sa atyre që u jepen fushës femërore. Shembuj të animeve dhe praktikave të tilla që janë mirë të dokumentuara përfshijnë:

- Pritshmëri të ndryshme për sjelljen e vajzave dhe djemve (vajzat të jenë të pastra dhe të qeta, djemt të jenë aktiv dhe të mendonjë në mënyrë të pavarur;
- Pritshmëria që djemt dhe vajzat të kenë arritshmëri superiore në lëndë të ndryshme (p.sh. djemt-matematikë dhe shkenca, vajzat – gjuhë dhe art;
- Zgjedhja e nxënësve për t’i kryer rutinat (p.sh. pastrimi i tabelës) apo për të ofruar ndihmë (p.sh. mbajtja e karrigeve) në bazë të gjinisë së tyre;
- Përdorimi dominues i formës mashkullore të gjuhës duke nënkuptuar kështu se meshkujt janë më të rëndësishëm ose janë më superior se femrat; dhe
- Sigurimi i udhëzimeve të njëjta kur nivelet zhvillimore të gjinive janë të ndryshme (p.sh. zhvillimi gjuhësor te djemt dhe vajzat).

## Cili është dallimi në mes të klasës së verbër dhe klasës mike në aspekt gjinor?

E verbër në aspekt gjinor	Mike në aspekt gjinor
Përdorim dominues i formës mashkullore të gjuhës (përemri “ai” përdoret përveç kur është e qartë se personazhi është femër ose kur pozita në mënyrë tradicionale mbahet nga femrat, p.sh. infermiere.	Përdoret gjuhë gjithpërfshirëse në aspekt gjinor duke përfshirë format si ajo/ai kur i referohemi pozitive (p.sh. drejtor shkollor, mjek, fermer, inxhinier, politikan apo përdorim të termave neutral gjinorë, p.sh. kryesues, njerëzim, zyrtar policor).
Qasje që i jep peshë rolit të mashkullit në shoqëri (foto të ushtarëve meshkuj).	Edhe sfera publike edhe private e jetës projektohen me vlerë të barabartë. Vlerësimi i kontributit në shoqërinë Kosovare si tash edhe gjatë historisë si nga meshkujt ashtu dhe femrat.
Funksionet shoqërore dhe publike i atribuohen gjinisë mashkullore (pozitat udhëheqëse si drejtor shkollor – përdorim i përemrit të gjinisë mashkullore, stereotipe të ri-forcuara, përdorim i “nipa” kur i referohemi mbesave dhe nipave).	Përdorim i ajo/ai apo asaj/atij dhe/apo përdorim i emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore. Ndryshim i qëllimshëm i roleve tradicionale (p.sh. “kujdestar fëmijësh, ai” apo “fermere, ajo”).
Librat shkollor dhe literatura, etj. Konsiderohen të barabarta për të gjithë nxënësit (kur qartazi i favorizojnë rolet mashkullore, etj. në shoqëri).	Sigurimi dhe përdorimi i materialeve mësimore, duke përfshirë tekstet shkollorë, të cilat janë gjithpërfshirëse në aspekt gjinor. Përdorimi i materialeve shtesë që sigurojnë balans (p.sh. që eliminon stereotipet) për tekstet shkollorë ekzistuese, literaturë dhe materiale tjera mësimore për t’i vetëdijesuar nxënësit për barazi gjinore.
Njësi mësimore që i paraqesin në mënyrë dominante personazhet meshkuj apo aktivitetet e përdorura (p.sh. sportet tradicionalisht mashkullore si të vetmit shembuj).	Përdorim i metodologjive (p.sh. zgjidhja e problemeve, hulumtimi në veprim, hulumtimi i pavarur, të nxënësve përmes projekteve) që e përkrahin të nxënët e bazuar në interesim të nxënësve. Përgatitni njësi mësimore dhe aktivitete që janë në interes edhe të vajzave edhe të djemve apo balanconi gjatë javës.
“Fajsimi” i nxënësit kur krahasimi apo faktorë të tjerë kompleks e shpjegojnë fenomenin (p.sh. vajzat nuk janë të interesuara në kompjutera, djemt ngurojnë të marrin pjesë në dramë).	Reflektim në sjellje jashtë “kutisë”. Përdorim i syzeve gjinore apo analizës për ta kuptuar sjelljen apo veprimin. Hulumto së bashku me nxënës çka e shpjegon sjelljen.
Pranimi apo injorimi i komenteve diskriminuese apo seksiste nga nxënësit apo të tjerët.	Përdorimi i qasjes së “momentit mësimdhënës”; procesimi i komenteve kur bëhen ato.

### Si duket klasa mike në aspekt gjinor?

Në një klasë ideale mike në aspekt gjinor, duhet të mbizotërojnë këto:

- Mjedisi fizik i përshtatet interesave dhe nevojave të djemve dhe vajzave. Vëmendje i kushtohet dritës, pastërtisë, mënyrës si ulen dhe fotografive/ilustrimeve.
- Komunikimi me nxënës demonstroi balans në mes të vajzave dhe djemve me shtytje pozitive të dhënë në mënyrë të barabartë për artitje. Të gjithë nxënësit inkurajohen të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e klasës me përkrahje të dhënë kur kërkohet për të siguruar mundësi të barabarta. Përdoret gjuhë me respekt gjatë gjithë kohës. Tolerancë zero për ngacmim dhe aktivitete tjera të bazuara kur një person përdor fuqinë në mënyrë të papërshtatshme mbi një tjetër.
- Mësimdhënia e përkrah vetëdijen gjinore në rritje nga nxënësit. Ajo gjithashtu reflekton vetëdije nga mësimdhënësi për anim gjinor – qoftë të dukshëm apo të fshehur – që ekziston në klasë me përjekje për ta ndryshuar këtë dinamikë me anë të zgjedhjes së metodologjive, se si i qasemi përmbajtjes dhe ilustrimeve në tekste shkollorë, dhe duke i adresuar porosinë krahasuese nga nxënësit.
- Klasa është një hapësirë e fuqishme ku të gjithë nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë dhe kënaqen me mësim në një mjedis të sigurt, pastër dhe jo-kërcënues; ku stereotipet adresohen dhe ku zbatohet principi i drejtësisë.

### Si ta bëj integrimin gjinor në klasë të suksesshëm?

1. Bëhu i hapur ndaj mundësisë se ke paragjykime.
2. Bëj një vetë-vlerësim duke përdorur listën kontrolluese në faqen tjetër.
3. Zgjedh së paku dy fusha specifike të cilave do tu ofrosh vëmendje të veçantë në mënyrë që ta përmirësosh praktikën tënde drejt klasës mike në aspekt gjinor
4. Shfrytëzo komentet dhe situatat e përditshme në klasë për ta promovuar vetëdijen gjinore

Lexo më shumë në ‘Arkën e Thesarit’ online. 

## Barazia Gjinore në Klasë

### Listë Kontrolluese për Mësimdhënës

#### Hulumtimet tregojnë se:

Hulumtimet tregojnë se animi gjinor ekziston në klasë. Shembuj të dukshëm përfshijnë:

- Djemt kërkojnë dhe marrin më shumë vëmendje nga mësimdhënësit e tyre.
- Kur djemt përgjigjen, ajo pranohet nga mësimdhënësi, kur vajzat e bëjnë të njëjtën gjë, mësimdhënësi i përkujton ta ngritin dorën.
- Djemt marrin informatë kthyesë më specifike nga mësimdhënësit andaj edhe më shumë udhëzim (të dobishëm për të mësuar më mirë).
- Sjellja këmbëngulëse e vajzave shihet si penguese (problem me karakterin) ndërsa këmbëngulja e djemve është sjellje e pranueshme.
- Mësimdhënësit tentojnë t'u japin detyra të ndryshme nxënësve bazuar në gjininë e tyre.
- Përdorimi i gjuhës dominohet nga gjinia mashkullore

#### Vetë-vlerësim:

- A i jap më shumë vëmendje djemve se sa vajzave?
- A jam më i/e vështirë ndaj vajzave kur bëhet fjalë për sjellje jo të mirë ("djemt janë djem" megjithatë)
- Si mësues, a ia jap fjalën më shumë vajzave gjatë vizitave në klasë pasi që e di se kanë më shumë shkathtësi gjuhësore në atë moshë?
- A i ftoj në mënyrë të barabartë si vajzat ashtu edhe djemt për ta bërë të njëjtën detyrë (p.sh. pastrimi i tabelës, lëvizja e karrigeve) në klasë?
- A ka më shumë mundësi t'i lavdëroj vajzat për pastërti, qetësi, ndërsa djemt t'i inkurajoj të mendojnë në mënyrë të pavarur, të jenë aktiv dhe të flasin hapur?
- A përdori gjuhë të ndryshme gjinore (p.sh. ajo/ai në vend të përemrave mashkullore).
- A i përdori "momentet e mësimdhënies" për t'i përkrahur nxënësit e mi të bëhen më të ndryshëm në aspekt gjinor?
- A i adresoj stereotipet gjinore kur paraqiten në klasë?
- Kur i përdor materialet mësimore ekzistuese dhe/apo të përgatitura, a bëj përpjekje të vetëdijshme për të qenë gjithpërfshirëse në aspekt gjinor (emrat e të dy gjinive, tregime apo shembuj në të cilat mund të identifikohen edhe djemt edhe vajzat, ilustrime që i largojnë stereotipet, heroina dhe heronjë)?
- A kërkoj ndonjëherë që vajzat dhe djemt të punojnë së bashku në të njëjtin grup?
- A pres që djemt të jenë më të mirë në matematikë dhe shkencë dhe të jenë më të interesuar në kompjuterë?
- A pres që vajzat të jenë më të mira në gjuhë dhe art?
- A bëj përpjekje të vetëdijshme për ta promovuar barazinë gjinore në klasë?
- A jam e/i vetëdijshëm për animin substancial gjinor në literaturën për fëmijë (përqindje e madhe e personazheve mashkuj në role udhëheqëse dhe stereotipe të roleve të femrave dhe meshkujve)?
- A kam pritshmëri të ndryshme nga prindi bazuar në gjininë e individit? A komunikoj me nxënësit me fjalë apo me vepra për këto pritshmëri?
- A jam e/i vetëdijshëm për animin tim gjinor; ndaj stereotipeve që i kam? Cilat janë ato?



## 2.17 Klasa gjithpërfshirëse

### Çka është klasa gjithpërfshirëse? Lexo më shumë në Doracakun e MASHT-it

Klasa gjithpërfshirëse është ajo klasë ku të gjithë fëmijët ndjehen të mirëseardhur dhe të dashur. Është ajo klasë ku të gjithë nxënësit kanë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe për ta arritur potencialin e tyre. Klasa gjithpërfshirëse është një vend ku praktikat diskriminuese apo përjashtuese adresohen ashtu që të gjithë që janë të përfshirë vetëdijesohen për paragjykimet e tyre dhe fillojnë t'i largojnë ato.



### Pse duhet të brengosem për gjithpërfshirjen në klasë?

E para dhe më e rëndësishmja është se edukimi është e drejtë themelore për të gjithë fëmijët. Mohimi i të mundësive të barabarta për edukim cilësor për një fëmijë është mohimi i të drejtës themelore të saj apo tij. Plani Strategjik i MASHT për vitin 2011-2016 bën thirrje për vendosjen e "masave për përmirësimin e gjithpërfshirjes dhe barazisë në edukim"<sup>10</sup>. PSAK vazhdon dhe thotë se "Kurrikula e re duhet të sigurojë mundësi të reja për të gjitha komunitetet pakicë dhe shumicë në Kosovë t'i ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kujdesen për kulturën e tyre etnike"<sup>11</sup>. Mësimdhënësit duhet të brengosen për gjithpërfshirjen ashtu që çdo nxënës të ketë mundësi ta sjellë pasurinë e tij apo saj e të qenit ndryshe në klasë – qoftë në aspekt të nevojave të veçanta arsimore, apo në aspekt gjuhësor, një nga kushtet fizike, situatë të ndryshme ekonomike apo çështje e talentit.

### Si duket një klasë gjithpërfshirëse?

Klasa gjithpërfshirëse përfshin:

- Secili nxënës ndjehet i mirëseardhur dhe i barabartë me të gjithë të tjerët;
- Mësimdhënia dhe të nxënësit adaptohen për t'i arritur nevojat e secilit fëmijë individualisht; mësimi i diferencuar përdoret si një nga qasjet;
- Nxënësit inkurajohen të punojnë në çifte apo grupe për t'i përkrahur nevojat e njëri-tjetrit (p.sh. në çifte për t'i ndihmuar njëri-tjetrin në zgjidhjen e problemave matematikore), nxënësi që ndihmon mëson shkathtësi të rëndësishme për jetë në këtë rol;
- Personeli tjetër i shkollës, prindërit dhe anëtarët tjerë të komunitetit ndihmojnë në klasë;
- Çështjet e diversitetit adresohen me çiltërsi dhe ndjeshmëri; dëshmitë e paragjykimet gjinor dhe stereotipeve përdoren si mundësi mësimi;
- Plani fizik i klasës adaptohet (p.sh. lartësia e tavolinës adaptohet për karrocë); dhe
- Mësimdhënësit janë të gatshëm ta ngritin nivelin e tyre të vetëdijes për praktikën e tyre që mund të jetë duke i kontribuar mjedisit jomiqësor të klasës për disa nxënës.

**Shih Doracakun e MASHT-it për strategji dhe aktivitete specifike.**

## Fusnotat

1. Korniza e Kurrikulit të Kosovës, MASHT, gusht 2011, faqe 3.
2. Ibid, faqe 13.
3. Ibid, faqe 14
4. Ibid, faqe 15
5. Vlerësim sumativ i cili nuk bëhet nga mësimdhënësi i nxënësve quhet vlerësim i jashtëm.
6. Sfida është përdaktuar nga Basic Education Program i USAID-it si pjesë e garës për sfidën e dizajnit.
7. Sadker, D., Sakker, M. (1994) Dështimi për Drejtësi: Si i Mashtrojnë Shkollat Tona Vajzat. Toronto, Ontario, Kanadë.
8. Chapman, Amanda, Animi Gjuhësor në Edukim, mund të gjendet në:  
[www.edchange.org/multicultural/papers/genderbias.html](http://www.edchange.org/multicultural/papers/genderbias.html) (i shikuar më 11 June, 2012)
9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në dipozicion në:  
<http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>, (e shikuar më 11 January 2012), Neni 8.
10. MASHT PSAK, faqe 70
11. Ibid, faqe 73

## Referencat

Hulumtimi në Veprim/Kërkimi i Mësimdhënësit. <http://www.mun.ca/sac/inquiry.html>

Vlerësimi për Nxënie – Përmirësimi i të nxënit dhe ngritja e standardeve.

<http://services.bglf.org/services/assess/a4learn.html>

Mësimi autentik: Hyrje praktike & Udhëzues për zbatim.

[http://ncsu.edu/meridan/win2003/authentic\\_learning/](http://ncsu.edu/meridan/win2003/authentic_learning/)

Udhëzime të diferencuara. [www.learnerslink.com/curriculum.htm](http://www.learnerslink.com/curriculum.htm)

Edukimi Ndërmarrës për Shkolla.

<http://www.teachernet.gov.uk/teachingandlearning/14to19/enterpriseeducation/>

Mjedis: FJPM-Fëmijët, Jashtë, Pjesëmarrje, Mjedis.

[http://www.norden.org/en/publications/2007-586/at\\_download/publicationfile](http://www.norden.org/en/publications/2007-586/at_download/publicationfile)

Animi Gjinnor në Edukim. [www.edchange.org/multicultural/papers/genderbias.html](http://www.edchange.org/multicultural/papers/genderbias.html)

Edukimi Gjithpërfshirës.

[www.unesco.org/.../strengthening-education-systems/inclusive-education](http://www.unesco.org/.../strengthening-education-systems/inclusive-education)

Edukimi Gjithpërfshirës. [www.inclusiveeducation.ca](http://www.inclusiveeducation.ca)

Kompetencat Kryesore në një Shoqëri të Bazuar në Njohuri.

<http://ed.europa/education/policies/2010/doc/basicframe.pdf>

Doracak për Praktikë të Përmirësuar në Klasë: Doracaku për mësues, Klasat 1-5. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2012.

Doracak për Praktikë të Përmirësuar në Klasë: Doracaku për mësimdhënës, Klasat 6-9. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2012.

Mësimdhënia përmes Lojës me Role. <http://serc.carleton.edu/introgeo/roleplaying/howto.html>

Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011-2016. Shih uebfaqen e MASHT ([www.masht-gov.net](http://www.masht-gov.net))

Korniza e Kurrikulit të Kosovës. Shih uebfaqen e MASHT ([www.masht-gov.net](http://www.masht-gov.net))

Partneriteti për Shkathtësitë e Shekullit 21. [www.21stcenturyskills.org](http://www.21stcenturyskills.org)

Të Nxënit e Bazuar në Probleme në Klasën me Fëmijën në Qendër.

[www.jeffutecht.com/docs/PBL.pdf](http://www.jeffutecht.com/docs/PBL.pdf)

Mësimi përmes projekteve. [www.edutopia.org](http://www.edutopia.org)

